

BASHKIM KUÇUKU
HISTORIOGRAFI, RISI, SHFORMIME
STUDIME, KUMTESA, RECENSIONE

BOTIMET TOENA

BASHKIM KUÇUKU

HISTORIOGRAFI, RISI, SHFORMIME

Letërsi shqipe bashkëkohore

II

studime, kumtesa, recensione

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-52-7

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

HYRJE

Historiografi, risi, shformime është vazhdim i librit *Pas eklipsit letrar* (2014), në rrafshe dhe për dukuri të tjera të letërsisë shqipe bashkëkohore.

Në fushën e *historiografisë* janë trajtuar disa koncepte dhe çështje themelore të letërsisë shqipe bashkëkohore: bashkëkohësia, metoda e realizmit socialist, disidenca, mjediset shoqërore kulturore të krijimit të saj, njësia kombëtare, bashkëjetesa mes realizmit, realizmit socialist, modernizmit, kriteret e hartimit të historiografisë së letërsisë, periudhizimi, kohështrirja e kësaj periudhe.

Risitë janë dukuri, që shënojnë dhe dallojnë njëren periudhë nga tjetra, përcaktojnë tiparet, arritjet e saj. Prej risive janë analizuar modernizmi bashkëkohor në poezinë dhe romanin shqiptar, epërsia e romanit në letërsinë shqipe, dukuria kryesore e bashkëkohëzimit me letërsitë e tjera europiane, analogjia, simbolika, alegoria, ironia, shumëformësia e trajtave rrëfimore në romane të Ismail Kadaresë, Mehmet Krajës, Zejnullah Rrahmanit.

Risisë së madhe historike, tej kontekstit kulturor shqiptar, botimit, vlerësimit dhe integritit të letërsisë shqipe në letërsi të tjera europiane e botërore, në radhë të parë, nëpërmjet veprës së Ismail Kadaresë, më

vonë të romaneve të Fatos Kongolit, Dritëro Agollit, Rexhep Qosjes, poezisë së Ali Podrimjes, Fatos Arapit, Xhevahir Spahiut, i është kushtuar kreu *Faqja europiane e botërore e letërsisë shqipe*.

Prej *shformimeve* shoqërore, botëkuptimore, morale, estetike, letrare të metodës së realizmit socialist, në vitet 1945-1990, të mishëruara në jetë, veprimtari, veçanërisht në krijimtari janë analizuar dyzimi psiko-moral e letrar i shkrimtarit me pasojat edhe në disa vepra konkrete të Ismail Kadaresë, Petro Markos, Dhimitër Xhuvanit, Mehmet Myftiut, Koço Kostës.

Tiranë, dhjetor 2018

LETËRSIA SHQIPE BASHKËKOHORE

1. Emërtime të ndryshme

Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit XX, në rrjedhën e kohës, ka pasur disa emërtime: a) *letërsi e Pasluftës së Dytë Botërore*; b) *letërsi e sotme*; c) *letërsi bashkëkohore*.

Emërtimi *letërsi e Pasluftës së Dytë Botërore* ka qenë i përbashkët për historiografitë e letërsive europiane, sepse kanë qenë mbështetur në të njëjtin referim kohor. Përfundimi i asaj katastrofe ishte datë e shënuar për mbarë njerëzimin. Për mos t'u përsëritur e kaluara dhe për të rritur mirëqenien pati ndryshime të gjithanshme: sistemet shoqërore, ekonomia, demokracia, të drejtat dhe liritë e njeriut, marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ndërkombëtare, teknologjitë, ndërkommunikimi njerëzor e kulturor, dhe në varësi me ta edhe letërsitë. Me gjithë rrethanat paqësore ndihmuese dhe zhvillimet që ndodhën, 1945-a ishte thjesht një datë historike politike, prandaj, dhe konvencionale, e vendosur à priori. Nuk ishte e thënë se, pikërisht, atëherë filluan edhe ndryshimet cilësore në gjithë këto letërsi. Për letërsinë shqipe, si dhe të vendeve të tjera të Lindjes staliniste, pati edhe një faktor të rëndësishëm politik-shoqëror, vendosja e “sistemit socialist”, shoqëruar me ideologjinë e tij sunduese, metodën e realizmit socialist dhe censurën. Njëzet-tridhjetë vjet më vonë u zhvlerësua. Historiografitë kishin mundësi të gjenin referime të tjera, më të përshtatshme.

Letërsi e sotme, e parapëlqyer në biseda të përditshme, në media, në praktikën e punës universitare, përdoret edhe në kritikën dhe studimet e gjuhëve të tjera. Thuhet, p.sh., letërsi frënge, italiane, angleze e ditëve

të sotme. Përcaktori *e sotme* ka kuptimin, që *i përket ditës në vazhdim, që ka ndodhur sot, lidhet me kohën e sotme në të cilën jetojmë, i përket periudhës më të fundit*. Shtrirja e saj është e kufizuar midis ditës, apo ditëve të sotme, në ecuri e sipër, dhe e shumta, periudhës më të fundit. Në studime në gjuhë të tjera përdoret edhe përcaktori *e tanishme*. *Letërsi e tanishme* është ajo, që zhvillohet *në kohën kur flasim, në periudhën kur jetojmë ne, në shtrirje më të kufizuar*. Teksti *Letërsia frënge në të tanishmen/e tanishme* përfshin letërsinë e njëzet e pesë vjetëve, 1980-2005.¹

2. Koncepti bashkëkohor,-e

Nga përcaktorët e lartpërmendur, përcaktori *bashkëkohor,-e*, është i përpunuar teorikisht dhe i pranuar me vlerën e termit estetik.²

Bashkëkohor,-e, në shqip, është edhe në një trajtë tjetër, të barasvlershme, *bashkëkohës,-e*. Ky koncept përcakton atë që jeton, ose që ka pasë jetuar njëkohësisht, dhe sidomos, atë që ka prejardhjen, apo ka lulëzuar në të njëjtën periudhë. Prejardhje është data e lindjes së shkrimtarëve, e krijimit dhe e botimit të veprave, e shfaqjes së dukurive. Në pikëpamje të sendërtimit dhe të funksionit, letërsia është bashkëkohore, kur shkrimtari dhe lexuesi jetojnë në të njëjtën kohë, janë bashkëkohës. Përcaktuese është lidhja, marrëdhënia, konkretisht, *njëkohësia* midis tyre, e cila mund të jetë fare e qartë: Migjeni (1911), Petro Marko (1913), Shevqet Musaraj (1914), Dhimitër S. Shuteriqi (1915), Esad Mekuli (1916) kanë qenë bashkëkohës, sepse janë lindur në vite të afërta. Po ashtu, Bilal Xhaferi (1935), Ismail Kadare (1936), Rexhep Qosja (1936), Anton Pashku (1937). Në raste të tjera, njëkohësia është e vetëkuptueshme.

Nocioni, pikësëpari, është historik. Por, kur dy qeniet, apo edhe njëra prej tyre, i përket fushës së artit, letërsisë, estetikës, atëherë, nocioni është edhe estetik. Ndryshe nga termat e periudhave të tjera, që ofrojnë

¹ Dominique Viart, Bruno Vercier, *La littérature française du présent*, Bordas, 2005, 2008.

² Etienne Souriau, *Vocabulaire d'esthétique*, PUF, 1990, faqe 474-475.

vështrime diakronike, ai ofron vështrim sinkronik. Letërsia shihet në pamjen e tanishme, në atë që kap syri në horizontin e bashkëkohësit.

Koncepti është relativ. Koha rrjedh si lumi dhe nuk rri aty ku ishte. Ajo që ishte e sotme, bëhet e djeshme. Vendin e saj e zë ajo që dje nuk ishte. Krahas shkrimtarëve dhe lexuesve, që ishin, shfaqen të rinj, ndërsa, shkojnë të brezave më të moshuar. Me Lasgush Poradecin, Mitrush Kutelin, Ernest Koliqin, në vitet 1950, ishin bashkëkohës edhe Arshi Pipa, Jakov Xoxa, Kasëm Trebeshina, Martin Camaj. Në vitet 1960 u ndërfitën Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Bilal Xhaferi, Anton Pashku, dhe më pas, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Xhevahir Spahiu, Natasha Lako, etj. Pleksja e brezave e ndërlikon relativizmin e tij. Në varkën e kohës, shkrimtarët dhe lexuesit zhvendosen, nga pika e mëparshme, shkojnë në një pikë tjetër. Periudha bashkëkohore ka një fillim, që zhvendoset vazhdimisht dhe një fund të ri, që zëvendësohet vazhdimisht. Fundi i saj është çdo e sotme, e tanishme deri në kuptimin më të ngushtë.

3. Fillimet e mundshme

Si çdo periudhë, edhe kjo fillon aty ku shfaqen ndryshime thelbësore, breza të rinj shkrimtarësh, botëkuptime, dukuri, stile, poetika të reja. Për të përcaktuar fillimin e saj ka disa mundësi, meqenëse ai nuk rri në të njëjtën pikë.

1. Para njëzet-tridhjetë vjetëve mund të ishte në vitet 1930. Argumentet kanë qenë këto: Ishte shfaqur një brez i ri shkrimtarësh: Migjeni, Petro Marko, Shevqet Musaraj, Dhimitër S. Shuteriqi, Esad Mekuli, veprat e të cilëve, me përjashtim të Migjenit, janë pasuruar deri në vitet 1980, 2000, me një fjalë, përgjatë gjithë asaj që do të quhej bashkëkohore. Disa prej tyre dhanë ndihmesë në përpunimin e mendimit realist, kërkuan me këmbëngulje dhe ushtruan lëvrimin e letërsisë realiste. Vepra e Migjenit risoi poezinë dhe prozën. Me përmbylljen e krijimtarisë së brezit të tyre, fillimi nuk përlligjet të jetë më atje.

2. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht, në vitet 1945-1950, kur ka ndryshime të mëdha në rrafshin kulturor. Zhduket analfabetizmi, bëhet i detyrueshëm arsimit fillor, në shtetin amë dhe jashtë tij, në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, ku nuk kishte pasur arsim

në gjuhën amtare, e, për pasojë, as traditë letrare në kohët moderne. Arsimimi e bën çdo qytetar lexues potencial. Në Prishtinë doli revista e parë kulturore letrare *Jeta e Re* (1949), djepi në të cilin u përkundën shkrimtarët e ardhshëm të mjedisit të atjeshëm. Që atëherë, letërsia shqipe është me dy degë, dalë nga i njëjti trung. Midis mbrothësisë arsimore-kulturore dhe ecurisë së saj ka një kundërvajtje të madhe. Me ideologjizimin e skajshëm, atë e mbërtheu ngërçi i metodës së realizmit socialist, që nuk lejonte prirjet e lira dhe poetikat bashkëkohore. E shtrirë në sasi, propagandistike dhe të njëtrajtshme, me rënie cilësore, dha pak vepra të qëndrueshme, nga të cilat ishin të rralla ato që panë dritë botimi për arsye se, ishin jashtë realizmit socialist. Meqenëse periudhat, fillojnë me ngritje, dhe jo me rënie, është vështirë, që fillimi të jetë në vitet 1945-1950.

3. Fillimi, në kuptimin e plotë, i letrarësisë, risive, shkallares së lartë artistike, i llojshmërisë së poetikave, larmisë së brendive në poezi, në prozë dhe në dramë, janë vitet 1960. Krahas Petro Markos, Jakov Xoxës, Kasëm Trebeshinës, hynë vrullshëm: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Bilal Xhaferi, Azem Shkreli, Ali Podrimja, më ngadalshëm Anton Pashku, Martin Camaj, Rahman Dedaj, etj., duke formuar, si asnjëherë në histori, bashkësinë më të madhe të shkrimtarëve, që krijojnë krahas. Me formim kulturor e letrar bashkëkohor, mes tyre dhe me formim e pëlqime klasike, me perceptime për botën dhe artin fort të dallueshme, me ushtrimin me përparësi të poetikave, teknikave dhe mjeteve shprehëse moderne, me këmbëngulje, madje dhe rrezikuese, risuan rrënjësisht poezinë, tregimin, romanin dhe dramën, ngjashëm, aq sa lejonin rrethanat, me letërsi të tjera ballkanike e europiane. Për nga përfitimi i vlerave, lëvrimi cilësor i gjinive dhe i llojeve më të ndryshme, spikatja e individualiteteve të shquara, deri diku të bashkëkohëzimit me letërsitë europiane, vitet 1960 kanë qenë vite të një hopi të pandodhur më parë. Disa nga risitë:

a) Sintezat e larta artistike, njëkohësisht risore dhe moderne, shpesh edhe bashkëkohore.

b) Formësimi i romanit, i cili mbizotëroi mbi gjinitë dhe llojet e tjera. Hegjemonizmi i tij e shndërroi strukturën tradicionale të letërsisë shqipe, nga një strukturë e poezisë në një strukturë të romanit, duke i

dhënë një strukturë moderne bashkëkohore si në letërsitë e zhvilluara të gjuhëve të tjera europiane.

c) Ndikimi i ndjeshëm i poezisë së lëvruar në Kosovë dhe në diasporë, më pak i prozës dhe dramaturgjisë, në pasurimin dhe shndërrimet cilësore të mbarë letërsisë shqipe.

d) Vijimësia e stileve, poetikave, gjedhjeve strukturore dhe përftesave, të shfaqura e të formësuara, atëherë, zhvillohen në dhjetëvjeçarët e mëpasëm. Në përbërësit e poetikave kryesore, deri më 1990-n dhe më tej, është homogjene në një vijimësi. Faktor për këtë ka qenë edhe zotërimi i stileve dhe i poetikave të shkrimtarëve të afirmuar në vitet 1960, të cilët vazhduan dhe ende vazhdojnë të sjellin ndihmesa. Ata kanë qenë bashkëkohës edhe me lexuesit e viteve 1990, 2000, disa edhe me lexuesit e sotëm. Kështu, nga pikëpamja e brezave të shkrimtarëve, e poetikave dhe e ndihmesave, vitet 1960-1990-2000, përbëjnë një periudhë më vete.

e) Pohimi, mirëpranimi i letërsisë shqipe në letërsitë ballkanike, europiane dhe botërore, dyert e të cilave i hapi origjinalizmi i spikatur i dhjetëra veprave, mishëruar në poetika, struktura, teknika dhe mjete shprehëse moderne e bashkëkohore.

Në studimet dhe tekstet e kohës së monizmit, letërsia shqipe fillonte me Luftën Kundërfashiste Nacional-Çlirimtare. Njëmendësisht me të, fillonte krijimtaria e ideologjizuar e realizmit socialist. Me daljen në skenën e historisë të Partisë Komuniste, me propagandën e saj, filloi edhe ideologjizimi i organizuar i shkrimtarëve dhe i lexuesve, më parë nëpërmjet shtypit, trakteve, dhe më pas, edhe nëpërmjet tribunave, institucioneve dhe sidomos shkollës. Në programet dhe tekstet shkollore njëjtësohej qëllimisht me krejt letërsinë shqipe, për të rrënjosur bindjen se, nuk kishte tjetër. Mirëpo, ajo ishte vetëm një pjesë e saj, ndonëse në sasi më e madhja, dhe një kahe, më i propaganduari, sepse krahas saj ishte edhe krijimtaria e shkruar dhe e pabotuar në Shqipërinë shtetërore, e shkruar në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në diasporë. Për këtë argument, fillimi i letërsisë shqipe me të gjitha kahet nuk mund të jetë në vitet e luftës kundërfashiste. Sidoqoftë, problemi i fillimit mbetet ende i hapur dhe këmbyes/alternativ. Me kalimin e viteve do të dalin këmbyses/alternativa të tjera.

4. Ngjarje të rëndësishme

Periudha e shkurtër e mendimit të lirë, goditjet ndaj tij

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore pati përpjekje për të nxitur shkrimtarinë letrare. Ngjarje përbënte dalja e revistës kulturore të përmuajshme *Bota e Re* (1945, korrik). Po ashtu, pati mendime dhe kërkesa, që veprimtaria e shkrimtarëve të organizohej. Në shtator 1945 formohet, në Tiranë, *Komisioni Nisjator* për themelimin e një organizate, i përbërë nga shkrimtarë të botëkuptimeve, prirjeve dhe brezave të ndryshëm: Imzot Vinçens Prenushi, Sefulla Malëshova, Aleksandër Xhuvani, Ali Asllani, Skënder Luarasi, Lasgush Poradeci, Dhimitër Pasko, Selim Shpuza, Sterjo Spasse, Dhimitër S. Shuteriqi dhe Shevqet Musaraj. Më 7-11 tetor 1945, në Tiranë, në Konferencën e tyre të parë, shkrimtarët diskutuan gjerësisht dhe vendosën themelimin e organizatës së tyre me emërtimin Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, e cila miratoi edhe statutin. Qëllimi i saj ishte, që duke u bashkuar në një organizatë të kishin mundësi të ndihmonin njëri-tjetrin, dhe nëpërmjet saj, t'u krijoheshin kushte të përshtatshme pune për zhvillimin më të madh të kulturës, veçanërisht të letrave shqipe. Konferenca e mendonte Lidhjen e Shkrimtarëve një organizatë jopolitike. Në Raportin kryesor të saj pohohej: "*Lidhja e jonë nuk duhet të jetë një organizatë politike... ne na bashkon profesioni i ynë*"¹. Mund të thuhet se, në vitet 1945-1949, ka pasur një mendim letrar të shumëllojshëm dhe relativisht të lirë. Mendimet shpreheshin në auditore dhe në botime. Në redaksinë e revistës *Bota e re*, p.sh., krahas shkrimtarëve partiakë, punonin edhe Mitrush Kuteli, Nexhat Hakiu dhe Arshi Pipa, etj., që ishin larg dhe në kundërshtim me politikën partiake dhe ideologjinë zyrtare. Ky mendim i lirë vazhdonte të shprehej në sajë të platformës kulturore liberale të Sefulla Malëshovës, që ishte sekretar i KQ të PK, ministër i Arsimit dhe i Kulturës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve.

Instrument ideologjizimi dhe mbikëqyrjeje

Që herët u pa se, Lidhja e Shkrimtarëve nuk ishte një organizatë e lirë dhe e pavarur, por një instrument ideologjizimi, mbikëqyrjeje dhe

¹ Raport i paraqitur nga Dhimitër S. Shuteriqi, *Bashkimi*, 1945, 9 tetor.

detyrimi/imponimi ndaj shkrimtarëve. Kongreseve dhe konferencave përsëritej se, Partia e krijoi, prandaj, edhe ajo do ta drejtonte. Ka pasur një trysni të madhe të Partisë Komuniste, me mjete e forma të ndryshme, për të shkatërruar mendimin e lirë letrar dhe platformën liberale të Sefulla Malëshovës. Revista *Bota e Re*, pas tetë muajsh, nuk doli më (1946, shkurt). Në vend të saj filloi të dilte revista *Literatura jonë*, më pas *Letërsia jonë* (1947-1953) dhe pas tyre *Nëntori* (1954-1991), gazeta *Drita*, (1961-2007), organe të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. *Les Lettres albanaises* (1978-1990), në frëngjisht, botonte poezi dhe prozë të zgjedhur nga letërsia shqipe bashkëkohore dhe e traditës për lexuesin e huaj.

Redaksia e revistës *Literatura jonë* ishte vetëm me shkrimtarë partiakë, ose të përshtatur me ta. Në kryeartikullin e parë të saj kërkohet një letërsi e angazhuar dhe e mbarsur *me ideologjinë e re e të shëndoshë që përshkon gjithë vendin*. Mendësia zyrtare, që është edhe mendësia e redaksisë, i ndan shkrimtarët në dy grupe kundërshtarë dhe armiqësore. Një palë, është e lidhur me popullin, ndërsa, pala tjetër, që rri indiferente dhe larg popullit, është armike. *Literatura jonë*, premton se, *do të jetë tribuna e luftës kundër këtyre prirjeve që e shpien prapa letërsinë*. Botëkuptimi leninist, fushën e krijimit letrar e shndërroi në fushë luftime kundër letërsisë së lirë, në të cilën pati vazhdimisht “heronj” dhe viktima, fitimtarë partiakë dhe “armiç” të mundur. Sipas tij, reaksionarë dhe armiç emërtoheshin shkrimtarët bashkëkohorë dhe të mëparshëm, veprimtaria dhe vepra e të cilëve nuk përputhej me të.

Konferenca e Tretë e Lidhjes së Shkrimtarëve (1949, tetor), që u bë gjedhja shembullore për forumet e mëpasme të saj, dënoi publikisht mendimin e lirë, të quajtur borgjez e revizionist, kurse Lidhjen e Shkrimtarëve e tjetërsoi plotësisht në instrument të ideologjizimit partiak. Edhe në kuptimin organizativ e praktik, ishte gjedhja e forumeve të Lidhjes, e parapërgatitur për të goditur shkrimtarët me mendim të pavarur, ose kundërshtues, për të kërcënuar e nënshtruar të tjerët, që mendonin ndryshe. Në kuptimin letrar ishte shembullore për të negativizuar veprat që përgënjeshtrojnë ideologjinë marksiste-leniniste dhe për të detyruar/imponuar metodën e realizmit socialist, duke dhënë edhe veprat konkrete të shkërbimit/imitimit nga letërsia sovjetike.

Referuesit dhe një sërë diskutuesish thanë haptas, se krijimtaria e Faik Konicës, Gjergj Fishtës, Ernest Koliqit, Mitrush Kutelit, etj. ishte e klasave sunduese, kundërpopullore dhe kundërkombëtare, prandaj, nuk mund t'u jepeshin masave për lexim. Këtej e tutje do të cilësoheshin armiq dhe veprat e tyre kundërpopullore dhe kundërkombëtare. Konferenca ishte organizuar për të goditur Sefulla Malëshovën, pikëpamjet dhe përkrahësit e tij. Ai u cilësua me pikëpamje borgjeze, revizioniste, armiqësore, u shkarkua nga funksionet, iu hoq e drejta e botimit dhe e kaloi jetën në internim. Me gjithë ndëshkimet e ashpra, që binin mbi çdo disident a liberalizues, disa vjet më vonë, Kasëm Trebeshina, Mark Ndoja dhe Mehmet Myftiu me mendime kundër realizmit socialist, *krijojnë, një grup të vogël, të cilin synonin ta zgjeronin.*¹ Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja, drejtues partiakë, duke parë njëtrajtshmërinë, ngurtësinë e madhe dhe anakronizmin e theksuar të letërsisë, filluan ta lironin disi censurën, e hapën sidomos drejt përvojave bashkëkohore europiane. Plenumi IV i KQ të PPSH-së (1973) i ndëshkoi bashkë me shkrimtarët që kishin guxuar të dilnin nga skema. Edhe në trevat jashtë Shqipërisë shtetërore pati një lëvizje kulturore dhe letrare, që në vitet 1940-1950-të, u fuqizua vazhdimisht, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm, ku u shkrua një pjesë e madhe e letërsisë shqipe. Në Prishtinë doli revista e parë kulturore dhe artistike në shqip *Jeta e re* (1949) dhe *Fjala* (1968), të cilat kanë luajtur rol të ndjeshëm në nxitjen e zhvillimit të letërsisë dhe në njohjen e ndërsjellë të veprave andej dhe këtej kufirit. Në mjedisin e Prishtinës ka pasur debate dhe kritika të lira, një mendim dhe krijimtari avangarde, që e afronte dhe e bashkëkohëzonte letërsinë shqipe dhe shkencat letrare me ato europiane perëndimore. *Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës* kishte po atë mision, ndonëse e liberalizuar, që kishte edhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë shtetërore. Në Shkup doli *Jehona* (1962), revistë shkencore, artistike, letrare e kulturore. Ernest Koliqi dhe Martin Camaj themeluan dhe nxorën revistën disidente *kulturore, shoqërore dhe*

¹ Referat i Komitetit Drejtonjës të Lidhjes së Shkrimtarëve, mbajtur nga shoku Dhimitër S. Shuteriqi, *Nëntori*, 1954/3, faqe 91.

artistike Shêjzat (Romë, 1957-1974), e cila përcolli me profesionalizëm dhe dashamirësi jo vetëm botimet në diasporë, por edhe letërsinë shqipe në mbarë hapësirën etnike.

5. Ndërlikueshmëria e procesit të krijimit letrar

Letërsia shqipe në vitet 1945-1990, ka pasur një ecuri dhe zhvillim mjaft të ndërlikuar, sepse mjaft të ndërlikuara kanë qenë edhe rrethanat politike, shoqërore dhe letrare në të cilat është shkruar, dhe në pjesën më të madhe, është botuar. Në sistemin stalinist, krijimtaria letrare, nga njëra anë, nxitej dhe përkrahej, dhe nga ana tjetër, kufizohej, tjetërsohej, ose shkatërrohej, kur ishte jashtë metodës së realizmit socialist. Prandaj, ka pasur faktorë përcaktues, që e kanë nxitur zhvillimin, po ashtu, dhe faktorë, që e kanë penguar atë. Parësor për zhvillimin ka qenë arsimimi i të gjitha klasave dhe shtresave të popullsisë në hapësirën shqiptare, brenda dhe tej kufijve të shtetit shqiptar. Për herë të parë shqiptarët në ish-Jugosllavi, në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi fituan të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare, kuptohet, edhe të shtypit e letërsisë. Arsimimi i detyrueshëm fillor u plotësua me arsimimin e mesëm masiv dhe të lartë. U hapën Institutet e Larta Pedagogjike në Tiranë (Dyvjëçar 1946, Katërvjëçar 1951), Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1958), më vonë edhe në qytete të tjera, që përgatisnin mësuesit për dijet më të ndryshme. Më 1957 hapet Universiteti Shtetëror i Tiranës, dhe më 1970, Universiteti i Prishtinës, dy ngjarje të mëdha historike, që në vite ndryshuan botëkuptimisht e kulturalisht botën shqiptare, mes tyre përshpejtuan edhe risimin e pasurimin e letërsisë. Arsimimi i përgjithshëm krijoi lexuesin masiv me kulturë mesatare, arsimimi i lartë elitën intelektuale, që janë faktori objektiv kryesor i zhvillimit harmonik të letërsisë e sidomos të romanit. Në këto kushte të përshtatshme, talenti, kudo të ishte, në qytet dhe në fshat, kishte mundësi të shfaqej dhe të sendërtonte vetveten. Ai kishte përkujdesin e shoqërisë dhe ndihmën e institucioneve shkolllore, kulturore e ideologjike, me bindjen à priori, se do të shkruante sipas gjedhjes ideologjike të realizmit socialist. Arsimimi masiv, duke rritur mundësinë e shtimit të numrit të shkrimtarëve, fuqizoi dukshëm, si në asnjë periudhë tjetër, faktorin

subjektiv, krijues. Tanimë, nuk ka disa shkrimtarë me emër, por, dhjetëra të tillë, të cilët e pasuruan, risuan dhe e ngritën letërsinë shqipe, në rastet më të arrira, në shkallare të letërsive europiane bashkëkohore. Përrjashtoheshin nga përkujdesja dhe ndihma ata, që kishin prejardhje nga klasat kundërshtarë të sistemit politik dhe ata, që kishin prirje tej realizmit socialist. Këta anësoheshin, e, nëse nuk heshtnin, apo nuk tjetërsoheshin mbi ta binte ndëshkimi shkatërrues. Rol përcaktues kanë pasur shkollat, në të cilat u formuan brezat e shkrimtarëve. Ato kanë qenë të ndryshme, perëndimore: franceze, italiane, europiane klasike, greke, dhe lindore: ruse, serbe, kroate, hungareze, bullgare. Ndërthurja e tyre në substratin krijues, që përftoi letërsinë, doli mjaft frytdhënëse. Shkrimtarët e disa brezave, që kanë dhënë ndihmesa kryesore, kanë qenë formuar para Luftës së Dytë Botërore, ose në shkolla perëndimore në Shqipëri dhe kanë vazhduar jashtë atdheut, ose pas Luftës, në shkolla shqiptare në fillimet e ideologjizimit dhe kanë vazhduar në vende të tjera.¹ Vetëm brezat e viteve 1960 e mbrapa nuk patën lidhje të drejtpërdrejta me shkolla dhe letërsi të tjera. Në ndeshjen midis

¹ Brezi i parë: Dhimitër S. Shuteriqi dhe Petro Marko, njëri kreu *Liceun Francez*, në Korçë, dhe studimet e larta për filozofi në Francë, tjetri *Shkollën Tregtare* italiane, në Vlorë. Brezi i dytë: Kasëm Trebeshina ndoqi *Normalen e Elbasanit* dhe studimet e larta në San-Petërburg/Leningrad (Rusi). Jakov Xoxa ndoqi *Liceun Francez*, në Korçë, *Normalen e Elbasanit* dhe studimet e larta për gjuhë dhe letërsi frënge në Sofje (Bullgari). Martin Camaj kreu *Kolegjën Saveriane*, në Shkodër, dhe studimet e larta për filologji, letërsi e filozofi, në Beograd dhe në Romë. Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi u formuan në shkollën shqiptare, kur ende programet dhe mësimdhënësit ishin në fillimet e ideologjizimit. Formimin e lartë e morën, ose, e pasuruan, përkatësisht, në Institutin e Letërsisë “Maksim Gorki” në Moskë (Rusi), Sant-Petërburg/Leningrad (Rusi), në Sofje (Bullgari). Letërsia ruse, sikurse dihet, është ndër më të njohurat, dhe atëherë, në gjuhën ruse ishin përkthyer dhe përktheshin veprat e njohura të letërsisë botërore. Nga shkolla e ideologjizuar dolën: Faik Ballanca, Xhevahir Spahiu, Fatos Kongoli, Koço Kosta, Zija Çela, Nasi Lera, Natasha Lako, Besnik Mustafaj, Mimoza Ahmeti, dhe të brezit të mëparshëm: Naum Prifti, Teodor Laço, të cilët nuk u formuan as në vende të Lindjes dhe as të Perëndimit. Kulturën letrare dhe letërsinë perëndimore e njohën nëpërmjet leximit në gjuhë të huaja.

arsimit dhe ideologjisë, që u ndërftua në shkollën shqiptare nga gjedhja sovjetike, fitoi, natyrisht, arsimit, sepse me dijet e shumëllojshme zhvilloi dhe emancipoi edhe talentet e shkrimtarëve të ardhshëm, ndërsa, ideologjia, sado ndrydhëse e kufizuese, ishte pjesa shtojcë e tij. Për anëtarët e Lidhjes kishte kushte lehtësuese. Në bazë të ndihmesave dhe të pritshmërisë u jepej leje krijimtarie një, disamujore, vjetore, disavjetore. Ndërprisnin punën në institucionin a në ndërmarrjen përkatëse për të shkruar veprën letrare. Paga ishte prej Lidhjes dhe më e lartë, se paga e institucionit a ndërmarrjes. Shkrimtarët e njohur kishin dhe orare pune të shkurtuara. Punonin 2, ose 4 orë më pak, se 8 orëshi i ditë-punës. Disa prej tyre ishin në profesion të lirë. Merreshin vetëm me krijimtari letrare. Shtëpitë Botuese *Naim Frashëri* (1947, 1951), në Tiranë, dhe *Rilindja*, (1950, 1958), në Prishtinë, prej nga dilte në dritë letërsia, ishin në pritje. Veprat pa probleme i përgatishnin në kohë të shkurtër. Përbri dhe përballë tyre ka pasur faktorë të tjerë, që e kanë penguar, kufizuar dhe çnatyruar: metoda e detyrueshme e realizmit socialist, censura e skajshme e saj, ndëshkimi i shkrimtarëve me mendim të lirë dhe kundërshtues, ndalimi i ndërkomunikimit me letërsitë e tjera moderne e bashkëkohore europiane. Organizimi shoqëror e kulturor, duke e nëpërkuluar sistematikisht formimin e shkrimtarëve dhe rrjedhën letrare në laboratorin ideologjizues, e ndërlikonte së tepërmi procesin e krijimit vetjak dhe krejt procesin krijues.

Për ata që mendonin për letërsi të lirë, në mospajtim me dogmën, e ndërlikuar ishte edhe vetë qeniesia/ekzistenca dhe qenia e shkrimtarit. Qeniesia/ekzistenca e tij gjallonte mes rrezikut të nënshtrimit e të tjetërsimit, që i premtonte lavdi dhe jetë normale, dhe rrezikut të humbjes së të drejtës së botimit, pra, të veprës, dhe asaj lirie të kufizuar të jetës. Kjo ishte ndeshja me realitetin shoqëror, metodën e realizmit socialist, censurën. Qenia e tij ndërlikohej edhe më tej. Nën trysinë fatpërcaktuese të jetës dhe të veprës, ai thyhej e ndahej më dysh, dyzohej. Në qenien e tij shfaqej tjetri, vetëcensura, nxënësi i shkollës, studenti i auditorit, shkrimtari, që kishte mësuar dhe i kishin detyruar për gjedhje krijimi metodën e realizmit socialist, i cili e ruante, e këshillonte, e lajmëronte për rreziqet, e ndalonte, e përndiqte. Në këtë qerthull ishte në mospajtim dhe në konflikt me vetveten. Të shkruante

natyrshëm vetveten sipas lirisë së brendshme, apo të shkruante tjetrin, veten e tjetërsuar sipas “lirisë” së detyruar, dogmës? Dyzimi i tij shtonte nyja të tjera ndërlikimi në procesin e krijimit në të cilin vepra ngjizej e çngjizej, bëhej e zhbëhej. Me ndërhyrjen e redaksive, më saktësisht, censurës fillonte një etapë tjetër, tanimë, e zhbërjeve-bërjeve. Zgjedhjet kanë qenë të ndryshme. Disa e braktisën vetveten për t’u njësuar me shkrimtarin e tjetërsuar. Jeta e tyre ishte e paqte e komode ndërsa vepra e mirëpritur. Të tjerë mbetën besnikë të vetvetes dhe të lirisë, u larguan prej metodës së realizmit socialist për mos t’iu kthyer më. Jeta e tyre kaloi burgjeve dhe internimeve, veprat e tyre disidente mbetën pa u botuar. Disa shprehnin vetveten, duke pasur parasysh censurën. Liria e kufizuar përftonte veprat e kompromisit, përgjithësisht jashtë dogmës, duke ruajtur kornizën e saj. Prej tyre, pas kritikës dhe ndalimit, pjesa më e madhe, edhe në kohësinë më të gjatë i shkruanin ato me programin e metodës besnike, prej së cilës nuk dolën më, të tjerët i largonin përherë e më tepër, të cilat nëpërmjet përftesave analogjike, simbolike, alegorike, eliptike mundën të botoheshin. Procesi letrar, i përbërë nga tërësia e këtyre ndërlikimeve vetjake, ishte një sistem ndërlikimesh, jo gjithmonë i njëjtësueshëm/identifikueshëm. Në mjedisin e Kosovës, në Maqedoni, në Mal të Zi rrethanat dhe procesi i krijimit nuk ishin kaq të ndërlikuara. Shkolla, letërsia, edhe pse të ideologjizuara e nën censurë, ishin më të hapura ndaj shkollës dhe letërsive perëndimore. Atje qarkullonte dhe përkthehej në shqip letërsia moderne bashkëkohore, autorët dhe veprat e ndaluara në shtetin amë, dhe po ashtu, lejoheshin prirjet tej realizmit socialist. Megjithatë, letërsia shqipe u risua dhe u pasurua si asnjëherë tjetër, dhe në një masë jo të vogël, u bashkëkohëzua dhe arriti në shkallaret e letërsive të tjera europiane. Pikërisht, në këtë periudhë, dhe për herë të parë në historinë e saj, dhjetëra vepra të përkthyer në prozë e në poezi, në gjuhët e kontinentit, bëhen pjesë vepruese në letërsinë europiane. Shihet qartë, se ka pasur një mospërputhje të madhe midis rrethanave shoqërore të vështira, kufizuese dhe ndaluese, dhe vlerave të spikatura, që janë krijuar në to. Prandaj, me të dhëna të tilla paradoksale natyrshëm vjen pyetja: Si është e mundur, që në sistemin stalinist, rrënues dhe të dështuar, të krijohen vlera të tilla? Dhe logjika shkencore përgjigjet: së pari, letërsia dhe kultura nuk njësohen, dhe shpesh as nuk

përputhen me sistemin shoqëror në të cilin krijohen. Së dyti, censura, sado e skajshme të jetë, jo vetëm nuk e zhduk, por as nuk e tjetëron plotësisht letërsinë e mirëfilltë. Vetë ajo, në shekuj ka përpunuar dhe përpunon forma dhe trajta të atilla, që e tejkalojnë censurën me të cilat është shkruar, zhvilluar dhe pasuruar, edhe në rrethanat më të vështira. Përveç kësaj, letërsia shqipe bashkëkohore është pasuruar ndjeshëm me krijimtarinë e shkruar në mjediset shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në diasporë, ku nuk vepronte një censurë e tillë.

6. Mjediset shoqërore-kulturore

Letërsia shqipe bashkëkohore, përveç problemit të fillimit të kësaj periudhe, ka edhe problemin e njëjtësimi të mjediseve shoqërore e kulturore në të cilat është shkruar.

Në Europë, zakonisht, hapësirat gjuhësore letrare janë përputhur me shtetet përkatëse kombëtare, sepse në to përfshihet shumica dërmuese e popullsisë. Ndërsa, hapësira gjuhësore letrare shqiptare, nuk përputhej dhe ende nuk përputhet me shtetin e përbashkët të shqiptarëve. Gati gjysma e saj ishte jashtë shtetit amë, në ish-Republikën Federative të Jugosllavisë. Problemi politik jetësor ka lindur edhe problemin vështirësues të letërsisë dhe të historiografisë së saj. Rrjedhimisht, edhe ajo është krijuar në mjedise të ndara, me dallime, që nuk mund të mos merren parasysh, pasi kanë pasur ndikimet e tyre në kahe dhe tipare të caktuara. Për këtë, në një farë mënyre, sidomos për ndarjen politike shtetërore të hapësirës gjuhësore e kulturore, mund të krahasohet me letërsinë gjermane, e cila u krijua në dy mjedise shoqërore kulturore të ndryshme, në Republikën Federale, me liri, pa censurë, dhe në Republikën Demokratike me censurë politike dhe metodën e realizmit socialist. Megjithëse, shkrimtarët në Kosovë ishin të lirë të lëvronin stilet e poetikat moderne dhe bashkëkohore, ndryshe nga në Shqipërinë shtetërore, ku dhe shfaqja më e vogël e tyre ndëshkohej ashpërsisht, sistemi politik shoqëror edhe atje, ishte i gjedhjes së Lindjes sovjetike, i cili e përhapte dhe e nxiti realizmin socialist.

Letërsia shqipe bashkëkohore është shkruar në katër mjedise shoqërore-kulturore e letrare, të ndara e të dallueshme:

1. Në shtetin amë, Shqipërinë shtetërore.

2. Në Kosovë, në trojet shqiptare nën Maqedoni dhe nën Mal të Zi. Këto hapësira gjuhësore kulturore, të ndara në tri Republika, Serbi, Maqedoni, Mal i Zi, përbëjnë një mjedis, sepse ishin në të njëjtat rrethana dhe me të njëjtën klimë politike kulturore të ish-Jugosllavisë.

3. Në diasporë, në vatrën e Romës (Itali), Mynihut (Gjermani), Minesotës dhe Çikagos (SHBA).

4. Në mjedisin e arbëreshëve të Italisë, me vatra tradicionale në Kozencë (Kalabri), dhe në Palermo (Sicili), në këtë periudhë, edhe në vatrën e arbëreshëve të Zarës, në Kroaci.

7. Dallimet e mjediseve, dallimet në krijimtari

Mjediset shoqërore dhe letrare në Shqipërinë shtetërore dhe në trevat shqiptare nën ish-Jugosllavi, përkatësisht, në Kosovë, nën Maqedoni dhe nën Mal të Zi kanë pasur dallime, në disa anë më të theksuara, dhe në disa të tjera më të zbutura. Në thelb ishte i njëjti sistem politik-shoqëror, i ashtuquajtur socializëm sovjetik, shoqëruar nga kultura e vet ideologjike, përmbledhur te metoda e realizmit socialist dhe censura e tij. Organizatat *Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë* dhe *Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës*, Institutet e Studimeve të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Shtëpitë Botuese *Naim Frashëri*, në Tiranë, *Rilindja*, në Prishtinë, *Flaka e Vllazërimit*, në Shkup; gazetën letrare *Drita* dhe revistën *Nëntori*, në Tiranë, revistat *Jeta e Re* dhe *Fjala*, në Prishtinë, *Jehona*, në Shkup, si dhe gjithë botimet i kishte në dorë shteti, i drejtonte dhe i financonte, nën mbikëqyrje. Shkrimtarët, për të shkruar, nxiteshin me mënyra të ndryshme, morale dhe lëndore, me kushte pune dhe jetese lehtësuese, për të përzgjedhurit, si edhe me privilegje.

Në Shqipërinë shtetërore metoda e realizmit socialist zyrtarisht mbeti përherë gjedhja e vetme e lejuar. Meqenëse, kufiri ndarës midis trajtimit realist dhe të realizmit socialist, p.sh., në tema të së kaluarës historike dhe në tema jopolitike të bashkëkohësisë ishte i kapërcyeshëm, pra, pa rrezik, pikërisht, aty ka qenë edhe shtegu më i rrahur prej nga ka nëpërshkuar një krijimtari e pasur në prozë, dramë e poezi, ndër sendërtimet cilësore, të qëndrueshme. Edhe nën klimën ngrirëse dhe nën censurën syhapur u shkruan vepra me brendi kundërtotalitare, disa

prej të cilave, me poetika moderne të sofistikuar, arritën të botoheshin. Ndonëse, me vijimësi të ndërprerë, ato shenjëzuan kahun e kundërt me realizmin socialist. Nga ana tjetër, me përbashkësi, ose duke qenë të të njëjtës gjedhje me ato që lëvroheshin lirshëm në Kosovë dhe në diasporë, janë segmente të të njëjtit kah. Pavarësisht gjedhjes njëformëzuese, që zotëroi në botime, në këtë mjedis, është krijuar, me realizëm dhe trajta të poetikave të modernizmit bashkëkohor, pjesa më e madhe dhe më e rëndësishme e letërsisë shqipe, boshti i zhvillimit të saj.

Me kohë, në ish-Jugosllavi, po ashtu, edhe në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi, metoda e realizmit socialist doli anash dhe u lejua qarkullimi i lirë i botëkuptimeve dhe i poetikave moderne bashkëkohore. Ndryshimi i klimës politike ndryshoi edhe formimin e shkrimtarëve, aq sa në vitet 1970-1980 e mbrapa, në poezi e në dramë do të zotërojnë stilet e poetikat moderne bashkëkohore. Krijimtaria e shkruar në këtë mjedis, që ka dalë natyrshëm dhe është ushqyer në traditën kulturore dhe letrare kombëtare, është pjesë e pandarë dhe e rëndësishme e letërsisë shqipe. Me risitë e veta avangarde ka shënjuar disa kulme të saj. Përveç ndarjes politike midis mjedisit në Shqipërinë shtetërore dhe në Kosovë, me komunikim të ndaluar, dhe në ndërkohë të shkurtra, me një lloj komunikimi tepër të kufizuar e të mbikëqyrur, ishte edhe ndarja, apo muri ideologjik, i ngritur nga institucionet e shtetit amë për të ruajtur realizmin socialist nga ndikimet e modernizmit. Veprat e autorëve nga Kosova, që ribotoheshin në Tiranë, ishin të pakta. Të përzgjedhura për të qenë sa më të përshtatshme, ato me poetika moderne nuk përfillehin sikur të mos ishin. Të pakta ishin edhe botimet e Prishtinës, që qarkullonin këtej nëpërmjet Bibliotekës Kombëtare. Ndalimi i qarkullimit të lirë, duke penguar zgjerimin dhe zhvillim e lidhjeve të brendshme të trashëguara nga tradita, krijoi zbrazëtira, fragmentarizëm dhe shpërqendrim mes dy krahëve.

Rënia e mureve ideologjike dhe politike i ka shpërbërë faktorët pengues dhe çintegruës. Mjediset shoqërore kulturore, si në Republikën e Shqipërisë dhe në atë të Kosovës, që po shkojnë drejt integritit të plotë, klima letrare përbashkuese, ndërkëmbimi i botimeve mes Tiranës, Prishtinës, Tetovës, zhvendosja e shkrimtarëve nga andej-këtej, dhe anasjellas, veprimtaritë e përbashkëta të tyre dhe të institucioneve

shkencore gjegjëse, njësimi i sistemit arsimor, i programeve dhe i teksteve formuese, mundësitë e barabarta të lidhjes me kultura e letërsi të tjera po i rrafshojnë dallimet thelbësore, e, bashkë me to, edhe pasojat e të kaluarës. Në diasporë nuk ka pasur mjedise letrare në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por disa vatra të shkëputura, larg njëra-tjetrës. Prej tyre do të përmenden ato që kanë luajtur rol në pasurimin e letërsisë shqipe, si degëzime të trungut të saj. Më e madhja dhe më e hershmja ishte në Romë (Itali), me një grup shkrimtarësh rreth Ernest Koliqit me revistën *Shêjzat* dhe Martin Camajt, që më vonë, kaloi në Mynih (Republikën Federale Gjermane) dhe ndezi atje një vatër të re. Dy vatra ishin në SHBA, njëra ishte hapur në Minesotë, nga Arshi Pipa, disidenti i parë i pasluftës, i mërguar prej atdheut, dhe tjetra, në Çikago, e ngritur nga Bilal Xhaferi pas mërgimit, rreth revistës *Krahu i Shqiptonjës*. Në vendet perëndimore, ku jetonin dhe krijonin, kishin liri të plotë, mundësi për t'u ushqyer me çdolloj literature dhe për t'u njohur me përvojat e reja, bashkëkohore. Qenia disident politik nxiti edhe më fort disidencën letrare, mishëruar në stile dhe poetika moderne, duke shmangur shpesh edhe realizmin. Krijimtaria e këtyre mërgimtarëve, të lidhur ngushtësisht me atdheun, të cilin e kishin marrë me vete, edhe pse është shkruar jashtë kontekstit të tij dhe është ushqyer drejtpërsëdrejti me burime kulturore të huaja, ka lëndën dhe problematikën e jetës shqiptare. Prirjet, stilet dhe poetikat, me ndonjë përjashtim, kanë dalë dhe rrjedhin brenda lumit të letërsisë shqipe.

Diaspora shqiptare nuk ka pasur qendra dhe veprimtari kulturore sistematike. Letërsia, sikurse libri shqip, qarkullonte vetjakisht mes intelektualëve, miqve e kolegëve, të njohur. Shpërndarja e madhe e shqiptarëve në vende të ndryshme të Europës dhe të SHBA-së, vështirësitë ekonomike, mungesa e organizimit e bënte, thuajse, të pamundur qarkullimin dhe leximin e saj, prandaj, nuk kishte lexues. Botimi ka qenë sakrificë ekonomike vetjake e rrallë me ndihmesën e dashamirësve. Ndërsa, hyrja në shtetin amë ishte e ndaluar, në radhë të parë, nga biografia e autorëve, të cilët ndëshkoheshin si tradhtarë se ishin larguar fshehtas nga atdheu "socialist". Brendia kundërtotalitare, poetikat moderne e moderniste, të papranueshme prej realizmit socialist, përmbushnin plotësisht dosjen ndaluese. Për të mos shkelur politikën

e shtetit amë, edhe në Kosovë e gjetiu në trojet shqiptare nuk lejohej qarkullimi i lirë i saj.

Mjedisi i arbëreshëve të Italisë, i shkëputur nga hapësira shqiptare, për vetë rrethanat dhe bazën shoqërore, është mjedis më vete. Ai është një ishullth në mes të kulturës italiane, që nëpërmjet filtrave të përpunuar në shekuj, ushqehet prej saj dhe prej traditës së pasur arbëreshe. Lidhjet e letërsisë arbëreshe me letërsinë shqipe, në mos anësore janë dytësore. Konteksti shoqëror, përjetimet, formimi, interesat, qëllimet e shkrimtarëve janë të tjera. Po ashtu, tjetër është letërsia dhe lexuesi i saj. Megjithatë, është përbashkuese gjuha e saj, arbërishtja, trajtë mesjetare e shqipes. Mjafton përkatësia gjuhësore për të qenë dhe për ta trajtuar si pjesë përbërëse të mbarë letërsisë shqipe.

Në vazhden e traditës së vet, edhe në këtë periudhë, është lëvruar, kryesisht, poezia. Dushko Vetmo (Françesko Solano), Vorea Ujko (Domeniko Bellici), Lluka Perrone, Zef Del Gaudio, Karmell Kandreva, Zef Skiro Di Maxho, Zef Skiro Di Modika e kanë pasuruar me motive bashkëkohore, ndjeshmëri lirike, herë-herë fluide, me abstraksione figurative moderne.¹ Dramturgu dhe poeti Josip Rela, poeti dhe prozatori Shime Deshpali, me arbërishten e Zarës, në Kroaci, kanë pohuar letërsinë e një mjedisi tjetër, të lidhur me problematika dhe përjetime, me letërsinë shqipe.²

Pas vitit 1991 gjendja, përbërja, marrëdhëniet e diasporës me Shqipërinë shtetërore, me Kosovën dhe me trojet shqiptare përreth, kanë ndryshuar rrënjësisht. Diaspora në njëzet vitet e fundit është shumëfishuar. Në bashkësitë e shpërndara, dhjetëra e qindra mijëshe, që jetojnë në Greqi, Itali, Gjermani, Zvicër, Suedi, Belgjikë, Britani e Madhe, SHBA, Francë, ka edhe një sërë shkrimtarësh të brezave të mëparshëm dhe të rinj. Disa bashkësi kanë Shoqata Kulturore, aty-këtu, edhe Shoqata Shkrimtarësh, të cilët me devotshmëri, shkruajnë shqip për të mos humbur lidhjet me letërsinë amë, dhe në gjuhë të huaja:

¹ Anton Nikë Berisha, *Antologji e poezisë bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë, Mësonjëtorja e parë*, Tiranë, 2001.

² Isak Shema, *Studime letare*, AAB University, Prishtinë, 2008.

italisht, gjermanisht, frëngjisht, greqisht. Qarkullimi i librave të tyre në atdhe, sadokudo, ndër-këmbimi i veprimtarive, përcjellja, në një farë mase, prej medias, kritikës dhe studimeve janë ndihmesa paraprake për të lehtësuar përfshirjen e saj në historiografi letrare.

8. Njësia e letërsisë

Krijimtaria e shkruar në Shqipërinë shtetërore, në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, në diasporën e re dhe në mjedisin e arbëreshëve të Italisë e të Zarës, në Kroaci, përbën letërsinë shqipe bashkëkohore. Pavarësisht nga rrethanat në të cilat është shkruar, kahet, apo drejtimet e ndryshme deri të kundërta, në tërësi, ajo është një, sepse vetiu është e njësuar në tiparet thelbësore e më të qenësishme.

Së pari, e gjitha është shkruar në gjuhën shqipe. Ka një përputhje universale midis letërsisë dhe gjuhës në të cilën është shkruar, dhe prej së cilës merr emërtimin. Letërsi frënge do të thotë, se është shkruar në frëngjisht, letërsi angleze, se është shkruar në anglisht, letërsi italiane, se është shkruar në italisht. Letërsi shqipe është e gjithë ajo që është e shkruar në gjuhën shqipe, qoftë edhe në shqipen mesjetare, në arbërisht.

Së dyti, sepse pas miratimit të gjuhës standarde (1972), me disa përjashtime, është shkruar me të, argument i padiskutueshëm i vetëdijes njësuere të shkrimtarëve dhe i vetë njësisë së saj. Përpjekje për t'u afruar a për të shkruar në shqipen standarde ka pasur edhe nga autorë arbëreshë.

Së treti, sepse është zhvilluar mbi traditën e përbashkët prej autorëve të vjetër: Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani; rilindësve: Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Faik Konica, Gjergj Fishta, Ndre Mjedja; autorëve të mëpasëm: Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Migjeni, etj. Me rrënjë dhe e ushqyer në traditën e përbashkët është e njësuar edhe në tiparet e saj thelbësore. Vijueshmëria thyhet ndjeshëm në letërsinë arbëreshe, e cila gjallon si qark i mbyllur, me disa fije ndërlidhëse, tradicionale e të reja, me tërësinë.¹ Në periudhën e monizmit ideologjik dhe estetik, në programe dhe tekste

¹ Për njësinë e brendshme të saj argumente të tjera jepen te studimi *Periudha e realizmit, realizmit socialist dhe modernizmit bashkëkohor*, me nëntitullin, *Njësia thelbësore e temave, strukturave, poetikave, stileve*.

shkollore është përdorur emërtimi i sajuar *letërsi kosovare* për ta dalluar nga ajo e realizmit socialist, për të paralajmëruar, se nuk është plotësisht e përshtatshme, se lexuesi i gjedhjes së ideologjizuar nuk do ta gjejë ashtu siç e dëshiron. Në tekstet e shkollave parauniversitare autorët dhe veprat e tyre ishin në ndarjen *Letërsi kosovare*. Në universitet, në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, ishte lënda *Letërsia kosovare*. Me këtë mbishkrim veçues botoheshin veprat e tyre në revista, gazeta dhe në libra.

Emërtimi është i paqëndrueshëm. Të ketë *letërsi kosovare* do të duhet të ketë *gjuhë kosovare*. Do të ishte më e pranueshme të quhej *letërsia në Kosovë* dhe *shkrimtar nga Kosova*, që shënjojnë letërsinë e shkruar dhe shkrimtarët që jetojnë dhe krijojnë atje. Me logjikën krahinoriste, si do të quhej ajo që është shkruar në Maqedoni, në Mal të Zi e gjetiu? Praktikisht nuk ka lindur ndonjë emërtim dallues për to. A do të ishte e rregullt dhe e pranueshme, që në kohët moderne, me koncepte shkencore kodifikuese të quheshin shkrimtarë shkodranë, korçarë, gjirokastritë, shkupjanë, tetovarë, ulqinakë, të diasporës, prej nga do të dilte letërsi shkodrane, korçare, gjirokastrite, shkupjane, tetovare, ulqinake, diaspore?

9. Kahet, apo drejtimet

Letërsia shqipe bashkëkohore, në pjesën më të madhe dhe më të rëndësishme është ideologjike, jo vetëm krijimtaria e realizmit socialist, pohuese e sistemit të vet totalitar, por edhe ajo kundërtotalitare e disidente. E ngjizur mbi ideologji dhe koncepte letrare të kundërta, ka dy kahe, apo drejtime të skajshme:

a) *Kahu, apo drejtimi i realizmit socialist*, i përbërë nga krijimtaria që doli nga metoda e realizmit socialist, është homogjene, e njëtrajtshme.

b) *Kahu, apo drejtimi disident*, i përbërë nga krijimtaria disidente, me brendi kundërtotalitare, është heterogjene në stile e poetika.

Krijimtaria e realizmit socialist

Krijimtaria e realizmit socialist u shkrua dhe u botua në Shqipërinë shtetërore, 1945-1990, një periudhë, edhe në Kosovë e vise të tjera shqiptare jashtë saj.¹ Për nga sasia, qarkullimi, përcjellja mediatike,

shkollore dhe akademike ishte mbizotëruese. Ajo nuk mund të kuptohet me brendinë ideologjike të pandryshueshme, njëtrajtshmërinë dhe funksionin e veçantë shoqëror, pa njohur metodën e saj, gjedhjen e fabrikës që e prodhoi në hapësirën shqiptare për 45 vjet.

Në Shqipëri, si dhe në vendet e tjera staliniste të Europës dhe të Azisë, erdhi e gatshme, e shoqëruar me propagandë, se ishte metoda më e përparuar, në përputhje me interesat e klasës punëtore dhe të sistemit socialist. Parimet e saj, të sajuara ishin përzierje konceptesh dhe kërkesash, kryesisht, shoqërore ideologjike me kërkesa letrare thjeshtëzuese, të detyrueshme për të gjithë ata që mendonin t'i botonin veprat e tyre, prandaj, nuk përbënin metodë. Sipas qëllimit dhe funksionit ishte mënyrë e mjet, që e vinte hapur letërsinë në vartësi të politikës zyrtare. Konkretizimin e përdorimit praktik e përpunonin udhëheqësit partiakë në Kongrese dhe Plenumet të Partisë për letërsinë dhe artin, shmangia sadopak prej tyre ishte herezi e ndëshkueshme.

¹ Krijimin e metodës së realizmit socialist ia veshin Andrej Zhdanovit (1896-1948). Në Kongresin e parë bashkues të shkrimtarëve sovjetikë, më 1934, Zhdanovi iu drejtua mendimeve teorike të Gorkit dhe thënies së Stalinit: “*Shkrimtarët janë inxhinierë të shpirtit njerëzor*”, për të dhënë prej kësaj ngjizjeje përcaktimin e mëposhtëm: “*Përveç kësaj, paraqitja artistike në ngjashmëri me të vërtetën, dhe historikisht konkrete, duhet të jetë e lidhur me punën e shndërrimit dhe të edukimit ideologjik të njerëzve veprues me frymën e socializmit. Kjo është metoda, që, në letërsi dhe në literaturën kritike, ne e tregojmë me emërtimin realizëm socialist*”. Prej fillimeve fjala ka qenë për një program didaktik të formimit dhe të edukimit të qenies njerëzore si punëtor socialist. Metoda e realizmit socialist, dhe krijimtaria e llojit të saj, e përpunuar në Bashkimin Sovjetik, pas Luftës së Dytë Botërore, u përhap edhe në vendet e tjera të quajtura socialiste të Europës dhe të Azisë: Çekosllovakia, Poloni, Hungari, Rumani, Jugosllavi, Bullgari, Kinë, Vietnam, Kore e Veriut, Kubë, Shqipëri. Ajo ishte shpallur dhe mëtonin ta kthenin në metodë universale, “më përparuesja për epokën e re, të sistemit socialist”. Nga shkrimtarë, zakonisht, komunistë, u propagandua dhe u ushtrua edhe në vende të Perëndimit: Francë, Greqi, Portugali. (*Histoire de la littérature européenne sous la direction d’Annick Benoit-Dusausooy et de Guy Fontaine, Hachette Éducation, 1992, faqe 824-825.*)

Kërkesat e saj ishin:

1. Kërkesa bazë ishte *partishmëria komuniste, ose proletare*, e njohur si *parimi leninist*, sepse e kishte formuluar (1905) dhe e detyroi/imponoi Lenini në praktikën letrare. Për të nuk kishte letërsi pa partishmëri, vetëm ndryshonin në brendi, qëllim dhe formë. Partishmëria proletare, që i shërbente proletariatit ishte e drejtpërdrejtë, e hapur, e sinqertë, kurse, partishmëria borgjeze, që ishte në shërbim të borgjezisë, ishte e kamufluar, e fshehtë, hipokrite. Në konceptin e tij, puna letrare bëhej pjesë e punës së organizuar e të planifikuar të partisë dhe letrarët anëtarë të saj. Në praktikën e krijimit do të thoshte se, letërsia, në tërësi, dhe çdo vepër në veçanti duhej të përshkoheshin nga ideologjia komuniste. Kjo ishte e paracaktuar si e vetmja brendi thelbësore, pavarësisht nga tema, koha dhe realitetit të cilit i drejtohej. “Teoricienët” shqiptarë e stërholluan, duke e kërkuar edhe në përbërës të tjerë: në zgjedhjen e karaktereve shoqërore, në tipizimin e tyre, në interpretimin ideor, ngarkesën emocionale deri në sistemin e figurave. “*Partishmëria shfaqet në brendinë ideore të veprave letrare, në zgjedhjen e karaktereve shoqërore, në procesin e tipizimit të këtyre karaktereve, në interpretimin ideor dhe në vlerësimin e tyre emocional; ajo është e shkrirë në tërë sistemin e figurave të veprës.*”, shkruhet në tekstin *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*.¹ I gjithë procesi i krijimit do të duhej të nëpërshkonte radhazi në laboratorin ideologjizues, në mënyrë, që çdo vepër të arrinte në të njëjtën pikë përfundimtare “*pasqyrimin e thellë e besnik të jetës*”², të cilin “*e siguronte partishmëria komuniste*”. Kështu, pasqyrimi me besnikëri i jetës barazohej me pasqyrimin e partishëm, ideologjik. Trajtimet e tjera cilësoheshin shtrembëruese të realitetit, ndonëse, parimi realist i pasqyrimin me besnikëri nuk njeh ndonjë ideologji. Pa argumente shkencore, teorike e të përvojës letrare, duke shpërfillur të vërtetën e njëmendët, këmbëngulej, se “*Partishmëria komuniste nuk e ndrydh*

¹ Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1978, faqe 6.

² Po aty, faqe 6.

lirinë e punës krijuese dhe as e frenon iniciativën e artistit”, kur historia njihje dhjetëra fakte, që shmangia nga dogma dënohej ligjërisht. Me “kritikën” ndaj ideologëve të borgjezisë, absurdja shkonte edhe më tej. “Janë fare të pathemelta pohimet e ideologëve të borgjezisë reaksionare se partishmëria komuniste bie ndesh me natyrën e artit”¹, këmbëngulej në tekstin *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, pa treguar “themelet” e teorisë marksiste-leniniste dhe as mungesën e themeleve të teorive borgjeze. Argumenti mbështetës ishte teoria letrare marksiste e leniniste, sipas së cilës, arti ka karakter klasor dhe shkrimtarët, me dashje, ose pa dashje, kanë qenë dhe janë në anën e një klase, e, për pasojë, shkrimtarët e realizmit socialist, nuk bëjnë tjetër, veçse shprehin interesat e klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse, që janë në pushtet.

Për të siguruar një brendi të tillë, në sistemin shkollor dhe jashtë tij, me literaturë dhe në kurse edukimi mësoheshin me përparësi nga shtresat shoqërore të ndryshme, komentime populërizuese të filozofisë marksiste-leniniste, që përfitonin botëkuptimin prej nga dilte e do të dilte letërsia e gjedhjes së kërkuar. Të njëjtin botëkuptim kishin edhe lexuesit kritikë. Me atë horizont pritjeje i pranonin të shëndetshme e gjenin kënaqësi të lloji i saj.

Edhe në veprimtarinë praktike, procesi i krijimit dhe i botimit kontrollohej hap pas hapi nga një varg institucionesh qendrore: Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, Drejtorja e Shtypit dhe e Botimeve në Komitetin Qendror të Partisë, në Kryeministri, në Ministrinë e Kulturës, në Shtëpinë Botuese *Naim Frashëri*, nga disa të tjera vendore, për të sendërtuar “*udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Partisë*”, ndryshe, rrjetin e kudoshtrirë të censurës.

2. *Heroi pozitiv*. Vazhdimisht i kërkuar, kishte tri funksione: ideologjik, didaktik/mësimues dhe le të thuhet, letrar. Ai ishte i domosdoshëm, sepse shëmbëlltyra e tij njerëzore, duke qenë bartëse e botëkuptimit, moralit dhe qëndrimeve komuniste, konkretizonte gjerësisht partishmërinë. Qenia në qendër të veprës përcaktonte zgjidhjen e konfliktit në këndvështrimin e idealit e të bëmave të tij tepër ndikuese

¹ Po aty, faqe 7.

edhe mbi bëmat e personazheve të tjera. Ndërsa, për horizontin e pritjes, censurën dhe lexuesin e përshtatur me realizmin socialist, ishte provë kontrolli e besnikërisë ideologjike të shkrimtarit. Nëpërmjet heroit pozitiv shihej qartë qëndrimi i tij ndaj realitetit socialist si objekt arti dhe njëherësh, ndaj sistemit politik. Duke qenë shëmbëlltyra e njeriut të ri, të formuar në socializëm ishte gjedhje edukimi për ta shkërbyer/imituar në jetë e në shoqëri. Ky ishte dhe qëllimi i përfshirjes së një kërkesë të tillë. “*Nëpërmjet këtij heroi triumfon e reja në jetë, pra, do të triumfojë edhe në art; kapërcehet ose shembet e vjetra në jetë, pra, do të kapërcehet e shembet edhe në art, krijohet shembulli i gjallë i punës krijuese, pra, do të krijohet edhe në art një shembull që t’i frymëzojë masat me dashurinë për punën, me shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit për çështjen e socializmit*”, përsëritej shpesh në referate të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe në studime mësimi partiak.¹

Thuhej, se ishte risi, por mishëronte vetëm njeriun ideologjik, përcillte *frymën pohuese* të letërsisë, pa ndonjë përftesë a shprehësi të re letrare. Portretizimi, vënia e tij në qendër, që merrej masë e pasqyrimin me besnikëri e jetës socialiste ishte kusht ideologjik i paravendosur e jo argument i letrarësisë. Të vërtetat e jetës mund të pasqyroheshin edhe në këndvështrimin e botëkuptimeve të tjera, e, në radhë të parë, të atij realist, të cilët nuk lejoheshin. Këshillohej të gjendej te paratipat e komunistit idealist, punëtorit, fshatarit, intelektualit të mirëformuar ideologjikisht, të përkushtuar në punë e të pastër moralisht. Dështimi më i madh ishte, pikërisht, në përpjekjet për portretizimin e tij. Në 45 vjet qenë të pakta figurat e tij me vërtetësi jetësore. Pengesa kryesore ishte pamundësia për ta gjetur në përditshmëri paratipin e tij të plotë, me jetë, ideal e botë shpirtërore në harmoni. Nga mospërputhja midis atij që kërkohej dhe atij që ishte njëmendësisht, vetë shkrimtarët nuk besonin, se do ta sendërtonin, prandaj, u mbetej të sajonin figura artificiale, laboratorike, utopike e jo shëmbëlltyra të gjalla njerëzore.

Meqë socializmi konceptohej, se përparonte mes luftës së klasave, midis klasës punëtore e fshatarësisë, nga njëra anë, dhe klasave të përmbysura, “armiçësore”, ish-çifligaro-borgjezëve, nga ana tjetër, heroi

¹ *Dokumente kryesore të PPSH*, vëllimi IV, Tiranë, 1970, faqe 570.

pozitiv ishte përballë *heroit negativ* dhe personazheve të tjera negative, të cilat paraqiteshin kundërshtare të egra e dinake, me veprimtari kundërpopullore. Në këtë përballje standarde, konflikti, ecuria dhe zgjidhja e tij, marrëdhëniet e personazheve vërtiteshin brenda të njëjtës skemë, të epërsisë së heroit pozitiv, i ngritur në pedestal, i idealizuar dhe i poetizuar, ngadhënjimtar i përhershëm. Nëse kishte rol dytësor ishte dobësi e kritikueshme, dhe më keq, mungesa e tij ishte e metë, arsye për të mos u botuar.

3. Një kërkesë tjetër ishte për *karakterin popullor*, i cili e lidhte letërsinë ngushtësisht me “*jetën e masave punonjëse për ndërtimin e socializmit*”, me veprimtarinë dhe rolin e tyre në forcimin e pushtetit politik, pa parë më tej, atje ku ishin klasat “armike”. Me këtë kufizohej edhe tematikisht liria krijuese e shkrimtarit. Nëpërmjet një lënde të tillë, të detyrueshme, thellohej, po ashtu, procesi i ideologjizimit. Personazhet, e ndërtuara mbi paratipa të marra nga “*jeta e masave punonjëse*”, mbartnin në vepra indoktrinimin e tyre. Matanë ishin klasat e rrëzuara, “armike”, gjendja e njëmendët e të cilave mbeti jashtë letërsisë. Edhe kur trajtoheshin nuk pasqyroheshin me realizëm e humanizëm, por me karakterizime negativizuese, të paracaktuara nga këndvështrimi i partishmërisë.

Karakter popullor, në shkallaren e funksionit, do të thoshte, afrim intelektual-emocional, lexueshmëri e kuptueshmëri nga shtresat e popullit. “*Arti dhe kultura jonë socialiste, - porosiste Enver Hoxha, duhet të mbështeten në tokën tonë amtare, në popullin tonë të mrekullueshëm, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij, të qarta e të kuptueshme për popullin, por aspak ‘banale e pa ide’*”¹.

Qartësia e kuptueshmëria prej popullit, pra, prej klasës punëtore dhe fshatarësisë, duke qenë masë pranimit, ose mospranimit pengonin abstraksionet e larta, simbolikat, alegoritë, parabolat. Letërsia elitare nuk pranohej nga horizonti i pritjes. Trajtat e fshehjes së përmbajtjes, paqartësia, dykuptimshmëria, errësimi i shprehjes, qoftë edhe për

¹ Enver Hoxha, *Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur në Kongresin V, botim i dytë, Tiranë, 1966, faqe 137.*

kënaqësi artistike, sidomos hermetizmi, shenjë e artit dekadent borgjezo-revizionist, ishin të pakalueshme nga censura.

Karakteri popullor i këtij lloji mohonte vetiu poetikat e reja, të panjohura e të pamësuara në shkollë, prandaj, edhe të pakuptueshme e të papranueshme prej tyre. Ishte një tjetër përlligje e mbylljes në vetvete, e shkëputjes nga rrjedhat letrare bashkëkohore në Europë e gjetkë. Lexuesi dogmatik, i mësuar me realizmin socialist, taktikisht kundërvihet me shkrimtarët dhe nxitej për syçeltësi, të mos pranonte ato që ishin ndryshe nge gjedhja zyrtare.

4. *Lufta kundër ndikimeve të huaja*. Politika dogmatike në Shqipëri vazhdonte ta shilte shoqërinë njerëzore bashkëkohore, sikurse e kishte ndarë Lenini, para 70 vjetësh, me fitoren e Revolucionit Bolshevik në Rusi (1917), në dy kampe të mëdha armiqësore: sistemi socialist, i barazisë dhe i drejtësisë shoqërore, me vendet staliniste të Europës dhe të Azisë, dhe sistemi kapitalist, veçanërisht vendet Perëndimore të Europës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku sundonte shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Për pasojë, shkollat, rrymat filozofike dhe letrare, që shfaqeshin atje ishin “armiqësore”, të huaja, degjeneruese, dhe si të tilla, nuk lejoheshin të qarkullonin dhe të ushtroheshin në letërsinë shqipe. Sipas enverizimit, Perëndimi kapitalist nuk reshte përpjekjet për ta shkatërruar socializmin nëpërmjet degjenerimit të tij të brendshëm me anë të përhapjes në të, të mënyrës së jetesës, së filozofive, teorive dhe rrymave letrare. Kështu, kishte ndodhur në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste, që ishin “pajtuar” dhe “bashkëpunonin” me borgjezinë, duke i hapur rrugën edhe letërsisë dekadente. Ndryshimet liberalizuese, të etiketuara “tradhti” ndaj marksizëm-leninizmit, revizionime të tij, ishin shkaku i shkëputjes së Shqipërisë prej tyre. Revizionizmi, i përngjitur me borgjezinë, tanimë, në rrezikshmëri ishte i barasvlershëm me të. Mblesërimit iu përshtat emërtimi: *ndikime të huaja, degjeneruese, borgjezo-revizioniste*. Prej këtij parashtrimi, arrihej në përfundimin se ishte e domosdoshme lufta kundër tyre. Strategjia, mënyrat dhe mjetet e saj përpunoheshin me kujdesin më të madh nga vetë Enver Hoxha në Kongrese dhe Plenumet e Partisë. Shmangiet ndiqeshin me lupë. Më i shënuari në historinë e ndëshkimeve të ndikimeve të huaja ka mbetur Plenumi IV i Komitetit

Qendror të Partisë, më 1973. Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja, udhëheqës të lartë në fushën e ideologjisë dhe të kulturës u shpallën armiq dhe u dënuan me burgim. Shkrimtarë dhe artistë u burgosën. Të tjerë u internuan, u dërguan në rrethe, në malësi e fshatra, u zbritën nga detyrat, u kritikuan dhe u denigruan publikisht. Situata zyrtare, e zbutur, pa ndëshkimet konkrete të shkrimtarëve, përshkruhet deri diku edhe në këtë paragraf të *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*: “Karakteristike për krijimtarinë e këtyre viteve ka qenë lufta e ashpër ideo-estetike kundër ndikimeve të huaja, sidomos të natyrës liberale, që ishin vënë re në vepra të veçanta para Plenumit IV. Lufta për të ruajtur pastërtinë ideologjike të letërsisë ka qenë dhe është e vazhdueshme, veçanërisht në kushtet e rrethimit imperialist-revizionist, të agresionit ideologjik... .. Sukseset janë arritur duke luftuar shfaqjet që kritikoi Plenumi IV, siç janë: hermetizmi dhe formalizmi, që u dukën në poezi; objektivizmi dhe humanizmi abstrakt, që u vunë re në krijime të veçanta në prozë; largimi nga realiteti dhe nga heroi pozitiv, shtrembërimi i së vërtetës jetësore, që u shfaq në dramën e armikut të Partisë, Fadil Paçrami dhe të ndonjë pasuesi të tij”¹.

Në të vërtetë, “filozofia” e arsytimit ishte alibi për të përlligjur mbylljen e dyerve kulturore jo vetëm me Perëndimin “kapitalist”, përkatësisht, të mendimit të lirë, por edhe me Lindjen “socialiste”, që po liberalizohej, prej nga i vinte rreziku stalinizmit shqiptar, i mbajtur fort pas metodës së realizmit socialist.

Institucionet e censurës, qendrore dhe vendore, sidomos në ndërkohën 1965-1990, mbyllën radhazi çdo derë e dritare nga mund të hynte letërsia bashkëkohore, teoritë e reja letrare e gjuhësore. Libri i huaj, përveç llojit realist, që kalonte filtrin, nuk ishte në librari. Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare vinte rrallë e më rrallë. Edhe atë e lexonin specialistë të besuar, me autorizim të miratuar në Drejtorinë e Shtypit dhe të Propagandës të Komitetit Qendror të Partisë. Disa

¹ Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1978, faqe 380-381.

shkrimtarë, nga më të njohurit, ishin lejuar, vetjakisht, të porosisnin e, prapëseprapë, kishte raste që nuk ua jepnin.

Në Tiranë nuk u botua asnjë vepër e autorëve modernë e modernistë të shekullit XX: Franc Kafka, Xhejms Xhojsi, Samuel Beketi, Eugjen Jonesko, Natali Sarroti, ishin në krye të listës së ndalesave, objekt i kritikave për tjetërsimin e qëllimshëm të letërsisë, që shkurajonte dhe degjeneronte shoqërinë për t'iu nënshtruar shtypjes kapitaliste. Nuk u botuan as Alber Kamyja dhe Zhan Pol Sartri, të cilët kishin qenë edhe anëtarë të Partisë Komuniste Franceze, përkundrazi, kritikoheshin dhe denigroheshin një lloj me të tjerët. Po ashtu, nuk botoheshin veprat me frymë liberalizuese, kundërstaliniste e me poetika moderne të shkrimtarëve të njohur të vendeve socialiste, me argumentin se ishin letërsi revizioniste.

Metoda e realizmit socialist, ende pa u njohur mirë, u përqaftua me ëndje mirëbesimi, prej një pjese shkrimtarësh, kryesisht, të ardhur nga lufta partizane kundërfashiste. Me kalimin e kohës e kuptuan, se lirisë po i zihej frymëmarrja, prandaj, herë pavetëdijshëm dhe herë vetëdijshëm e kalonin vijën e kuqe. Nga këta dolën disidentë. Edhe ata, që për mendësi tradicionale, praktikisht i qëndruan besnik deri në fund, ishin të bindur për kufizimet dhe fatkeqësinë e veprave. Shkrimtarët më të rëndësishëm e më frytdhënës të brezit të dytë e zbatuan dhe e mbrojtën me artikuj për kompromis botimi, ndonjë edhe për karrierë. Ata të brezave të mëparshëm, të ardhur nga vitet 1920-1930, me përjashtime të rralla, nuk e pranuan, disa e kundërshtuan haptas, disa me heshtje, dhe me aq sa mundën, vazhduan me stilin e tyre.

Poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, komedi të realizmit socialist kanë shkruar të gjithë shkrimtarët që botonin atëherë.

Poezia

Dogmatizmin, për lehtësi të vetë llojit, fillimisht e përqaftoi dhe e përhapoi poezia, duke u ngjitur shkallare-shkallare, nga propagandistike e thjeshtëzuar, në metaforike e simbolike, jo rrallë me shprehësi të lartë, ndonëse, përherë e ideologjizuar, patetike. Më të popullarizuara, në vitet 1950-1960, kanë qenë: poema e Aleks Çaçit, *Ashtu, Myzeqe* (1947), propagandim i vjershëruar për kolektivizimin e bujqësisë; poemat e

Llazar Siliqit: *Prishtina* (1949), oratori e poetizuar për qëndresën e dëshmorëve dhe të internuarve në kampin nazist të Prishtinës, ku kishte qenë edhe vetë autori, *Mësuesi* (1955), kushtuar mësuesit hero Ndreç Ndue Gjokës, mishërim i mësuesit popullor të atyre viteve, *Ringjallja* (1959), metaforë për “ringjalljen” e jetës në stinën e “pranverës socialiste”. Në vitet 1960-1970, spikatin poemat e Dritëro Agollit: *Devoll, Devoll* (1964), një monolog i hapur, ku subjekti lirik, i njësuar me poetin, intelektual komunist, përsiat në trajta të ligjërit bisedor, që e vë atë në një rrafsh me lexuesin, për lidhjen e ngushtë me atdheun dhe socializmin; *Baballarët* (1969), mirënjohje dhe nderim ekzaltues etërve, luftëtarë dhe bartës të traditës, të kritikuar ëmbëlsisht për disa mbeturina të së kaluarës; *Komunistët* (1971), panegjirik ritmik për bëmat “heroike” dhe “historike” të komunistëve në vite, përmbi të cilët ngrihet figura e Enver Hoxhës, që bëri “mrekullira”. Për shprehësi të lartë dhe risim të figuracionit të traditës, shquheshin dy-tri poema të Ismail Kadaresë, sidomos *Shqiponjat fluturojnë lart* (1966), një himn për Partinë Komuniste, në njëzetepesëvjetorin e themelimit. Simbolika e njohur e shqiponjës, e rëndomtësuar nga përdorimi i tepruar në përditshmëri dhe në letërsi, është zhvilluar në një sistem figurshmërie origjinal, të larmishëm dhe në shkallare shprehëse të ndryshme. Në kontekstin historik të pushtimit fashist të atdheut, ajo shëmbëllen komunistët ilegalë në veprimtarinë luftarake kundër tij, që të lidhur ngushtësisht në një trup, përbëjnë shqiponjën-emblemë, Partinë Komuniste. Emri i saj, i apostrofuar plot patos, sipas metaforave simbolike, do të ngjitej lart e më lart mes luftës kundër fashizmit dhe tradhtisë, si mes shigjetave të gjahtarëve. Ato fluturojnë lart, në kontrast me gjendjen e mjeruar të Shqipërisë së deriatëhershme, si, dhe nga pikëvështrimi bashkëkohor, kur është shkruar poema, prej nga dukeshin bëmat e saj në ndërtimin socialist.

Poezia e Fatos Arapit, veç origjinalizmit artistik, përftuar shpesh nga kryqëzimi i figurave pamore me ato dëgjimore, me domethënie vështirësisht të konkretizueshme, madje dhe hermetike, çmohej për ndjeshmërinë në trajtimin e motiveve të klasës punëtore dhe të luftës kundër fashizmit në të cilën kishte qenë pjesëmarrës në moshë të re. *Ritme të hekurta* (1968), titulli i një vëllimi, ishin ritmet e klasës

punëtore, të fabrikave dhe të uzinave, që i jepnin tonin jetës socialiste. Poezi të zgjedhura të tij dhe poemat *Alarme të përgjakura* (1966), *I përkasim komunizmit* (1966), *Antiburokratike* (1968), ishin arritje në llojin e vet.

Poema *Nënë Shqipëri* e Dritëro Agollit, e frymëzuar nga atmosfera festive e 30-vjetorit të çlirimit nga fashizmi dhe e fitores së revolucionit popullor (1974), e nderuar me Çmimin e Parë në konkursin e atij jubileu, arrin apogjeun e botimit. 100.000 kopje vetëm në një botim (i dyti) dhe nga 5.000 disa herë të tjera. Në të është njësuar arti me propagandën politike, nëpërmjet dy objekteve kryesore të ngritura në kult nga shoqëria: atdheu socialist dhe partia, betejat dhe fitoret e saj në fushat politike, ekonomike, ideologjike, kulturore. Tingëllimi i rrembit të traditës, që e përshkon, himnizimi i atdheut, kanë qenë përbërës të tjerë fortndikues. Autori, i nisur nga gjedhja e poemës *Bagëti e Bujqësi* e Naim Frashërit, me të cilën ishin intimiduar gjithë brezat e shqiptarëve dhe klasat shoqërore, pati për qëllim të shkruante një “*Bagëti e Bujqësi* të sotme, socialiste, të epokës së ndritur të Partisë”. E kthyer në mjet të propagandës së përditshme, recitohej në skena qendrore në Tiranë dhe në qytete të tjera nga aktorë profesionistë, amatorë, nxënës shkollash, punëtorë, kooperativistë, oficerë dhe ushtarë, në radio dhe televizion, në dokumentarë filmash.

Romani

Romani ishte një lloj dytësor i prozës, e zotëruar deri atëherë nga tregimi. Me traditë të paktë dhe më shpesh jocilësor, me lëndë dhe përftesa, kryesisht, romantike, ndërthurur me lëndë dhe përftesa realiste, i paformësuar në konceptin teorik, strukturë e praktikë krijuese hyri menjëherë në skemën e gatshme të realizmit socialist. Lëvruesit e tij të parë, me ndonjë përjashtim, ishin shkrimtarë të brezit të luftës partizane kundërfashiste dhe të brezit më të ri, që sapo kishin mbaruar studimet tre dhe pesëvjeçare në Bashkimin Sovjetik, në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki*, në Moskë, shkolla botërore e përhapjes së metodës së realizmit socialist. Shumë prej tyre, komunistë të organizuar në parti, rritur në Shqipërinë e varfër dhe të prapambetur në çdo pikëpamje, prandaj, dhe inferiorë ndaj atij realiteti, të bindur në mirësitë

“absolute” të socializmit, e zbatuan atë symbyllur, madje, me talentin e pamjaftueshëm e vulgarizuan. Romanet skematike shembullore, shkërbyese të gjedhjeve sovjetike u shkruan në vitet 1950-1960, kur kultura letrare e shkrimtarëve shqiptarë ishte e kufizuar dhe kritikata ndaj realizmit socialist, në vendet e Lindjes staliniste, nga shkrimtarë të po atij formimi, ishin ende të dobëta. Disa syresh kanë të huazuara gjedhjet strukturore të romaneve të njohura sovjetike: *Garda e Re* i Aleksandër Fadejevit, *Si u kalit çeliku* i Nikollaj Ostrovskit, *Doni i qetë* dhe *Tokat e çara* të Mihail Shollohovit, etj., me të cilat janë bashkëhuazuar prej tyre ide, tipa personazhesh deri në hollësi.

Kështu, romanet e para pa origjinalizëm artistik njëmendësisht ishin të dështuara. Në atë horizont pritjeje, i cili i jepte përparësi brendisë ideologjike, pse jo edhe përngjasimit të letërsisë sovjetike, shkallarja e ulët e artit nuk ishte masë mospranimi. Kritika dhe institucionet letrare e kulturore i quajtën arritje e madhe: Çlirimtarët i Dhimitër S. Shuteriqit (vëllimi I, 1952, vëllimi II, 1955), *Ata nuk ishin vetëm* (1952), *Afërdita përsëri në fshat* (1955) të Sterjo Spasses, *Përmbysja* (1954) i Fatmir Gjatës, *Një vjeshtë me stuhi* (1959) i Ali Abdihoxhës, etj. Për brendinë ideologjike u përfshinë, jashtë rregullave të provës kohore, në programet shkollore, parauniversitare dhe universitare, të cilët nuk u hoqën më, edhe pse letërsia u ngjiti në shkallare cilësore. Me epërsi të realizmit ishte *Hasta la vista* (1958) i Petro Markos, shkrimtar me vetëdije të lirë, romanet e të cilit i kapërcejnë vazhdimisht caqet e metodës zyrtare.

Objekt i romanit ishin tipat më të spikatur të punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve dhe të të rrëzuarve nga pushteti, me vetëdije, interesa dhe qëllime të caktuara politike, të cilët zbuloheshin në rrafshin shoqëror, dhe rrallë në atë intim, ndonëse edhe rrafshi intim hidhte dritë mbi to. Pikëvështimi klasor i detyrueshëm ishte dhe i vetmi i pranueshëm. Mirëpo, mbetej jashtë letërsisë tërë larmia e tipave të tjerë të jetës, prirjet e tyre të brendshme, pozitive dhe negative, konflikte, probleme të njëmendta, gjendje psiko-emocionale, fshehtësi intime të vetëdijes dhe të pavetëdijes, që nuk kishin lidhje me të.

Ngjyrat e portretizimit ishin skajshmërisht të kufizuara dhe kontrastuese: e bardhë dhe e zezë. Heronjtë pozitivë, shëmbëlltyra të njeriut të ri të socializmit janë në gamën e të bardhës në shkallëzime

të ndryshme, ngadhënjimtarë në ide dhe në misionin shoqëror, në bashkëkohësi dhe në të djeshmen. Edhe kur humbin tragjikisht jetën në veprimtari shoqërore, ngadhënjën ideali i tyre. Heronjtë e personazhet negative janë në gamën e të zezës: e errët, më e errët, tepër e errët, në vartësi të bëmave “të dënueshme”. Shoqërisht humbës, të zvetënuar, në rënie të vazhdueshme morale dhe psikologjike. Mishëruesit e tipave “të ndërmjetëm”, bartës “të mbeturinave të së kaluarës”, ose të “ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste”, janë të vizatuar me ngjyresa të murrme dhe kanë vetëm dy kahe veprimi. Një palë shkon përpara, duke ndjekur shëmbëlltyrën e njeriut të ri, ngjyra e murrme e të cilëve nis të zbardhet, kurse pala tjetër tërhiqet, apo shtyhet prapa në anën e heroit negativ, murrmësia e të cilëve merr për nga e zeza. Megjithëse thirrjet këmbëngulëse dhe “argumentet” nuk reshtën për dyzet vjet, sendërtimi cilësor i heroit pozitiv, që shpërblehej me çmime letrare dhe propagandë të posaçme, u arrit në pak raste, sepse ajo që kërkohet prej tij ishte tej të njëmendtës.

Ideologjizimi i përmbajtjes shkatërroi disa nga përbërësit thelbësorë të realizmit. Shkakësimi/motivimi i shumanshëm i personazheve, si ai i brendshëm, me anë të botëkuptimit, mendësive, interesave e qëllimit, ashtu, dhe i jashtmi, me anë të mjedisit dhe të rrethanave të veprimit, u zëvendësua me shkakësimin e njëanshëm ideologjik, prandaj, “shndërrimet” mirësuese dhe keqësuese të tyre janë të papërligjura. Me këtë tjetërsim, që u bë në vetëdijen dhe laboratorin krijues të shkrimtarit, ata humbën vërtetësinë karakteristike realiste, ndër vlerat më të rëndësishme. Përbërësit lëndorë dhe strukturorë, të paracaktuar nga skema e realizmit socialist, tjetërsuan zgjidhjet realiste të larmishme, sipas rrethanave dhe formimit të personazheve. Prej tyre hynte, në romane, e gatshme zgjidhja e përgjithshme e historisë, e njëjtë, pavarësisht rrethanave të përshkruara, nëpërmjet së cilës pohohej epërsia e sistemit socialist. Në funksion të një zgjidhjeje të tillë çnatyruese është konflikti klasor i pakapërcyeshëm, për pasojë, edhe vija ndarëse e linjave të veprimit. Dukshëm në të ndikon heroit pozitiv, prej të cilit merr drejtimin konflikti kryesor, dhe optimizmi revolucionar, i ndërfutur subjektivisht si rrymë e brendshme në gjendjet psiko-emocionale të personazheve dhe atmosferën e situatave.

Në vitet 1960-1980, brenda skemës së realizmit socialist, zgjerohen lënda dhe përftesat realiste me prirje më të theksuar për t'iu shmangur e për të dalë prej saj. Në romanet *Dimri i vetmisë së madhe*, *Koncert në fund të dimrit* të Ismail Kadaresë, *Njeriu me top*, *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* të Dritëro Agollit, *Juga e bardhë* i Jakov Xoxës, në tregime, novela e romane të Teodor Laços, Koço Kostës, Zija Çelës, Nasi Lerës u zgjerua hapësira realiste. Personazhet janë më të larmishme, dramatike, me kundërshti psiko-shpirtërore, që e shfaqin dhe e fshehin veten nëpërmjet mënyrave dhe me mjete karakterizuese të ndryshme, përqendruar te karakterizimi dhe analiza e thellë psikologjike. Në këtë vazhdë u përforcua kritika ndaj dukurive negative, duke venë disa herë në qendër personazhe negative, përfaqësuese të rrëgjara të sistemit politik. Ndërkohë, shfaqen e formësohen pak nga pak poetika, prirje ideore dhe stile të tjera, madje, në kundërshtim me të, veçanërisht me shprehësi analogjike, simbolike e parabolike për të kapërcyer censurën.

Sterjo Spasse (1914-1989)

Sterjo Spasse nga një familje me kombësi maqedonase, lindi në fshatin Gllomboç (Korçë). Kreu *Shkollën Normale* të Elbasanit. Studioi në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki*, në Moskë. Ishte bashkëpunëtor i revistës *Bota e Re* (1936-1937, Korçë) me drejtim të majtë dhe bashkëthemelues i Lidhjes së Shkrimtarëve. Ndhimesat e tij janë në themelet e formësimit të disa llojeve të romanit shqiptar: realist, të realizmit socialist dhe historik romantik.

Pse?!

Pse?! (1935), romani i parë me poetikë realiste të qëndrueshme, është, gjithashtu, edhe romani i parë me lëndë mendimore të pasur. Bëmat e heroit, Gjon Zaveri janë të përcaktuara prej mjedisit shoqëror, tej të cilit nuk e hedh dot hapin. Ndonëse e mendon ndryshe shoqërinë, jetën, njeriun, dashurinë, martesën, nuk ka mundësi dhe aftësi të shkëputet prej tij.

Historikisht ka qenë një risi e vetvetishme dhe avangarde, anash ecurisë së përgjithshme të romanit shqiptar ende të paformësuar, e cila nuk u vijua as nga Sterjo Spasse dhe as nga autorë të tjerë të asaj dhe të periudhës së mëpasme. Mes atyre pak titujve të botuar deri atëherë të llojit historik romantik, sentimental e realist, duke përjashtuar ndonjërin, me rrëfim të jashtëm për ngjarjen, me personazhe pa botë të thellë psiko-

shpirtërore, kësisoj, edhe pa shkakësime të brendshme, shfaqet *Pse?!*, me disa personazhe të tipizuara, të karakterizuara nga ndjesi të holla, veçanërisht me përsiatje nëpërmjet monologut në ditar, pararendës i monologut të brendshëm, që u arrit më vonë në modernizëm. Sapo doli në dritë ka pasur vlerësime dhe zhvlerësime nga shkrimtarë, kritikë dhe lexues, në shtyp dhe me letra drejtuar autorit. Vangjel Koça e cilësoi “roman i mohimit”, cilësim përcaktues, që nuk i është ndarë.¹

Tipologjikisht ka përbërës të llojeve të ndryshme të romanit, pa koherencë/pavijueshmëri, madje, me thyerje, në kundërvajtje me llojet e njohura në letërsi të tjera. I ndërtuar me arsyetime filozofike, nuk ka ngjashmëri me gjedhje të romanit filozofik, sepse në të hidhen mendime të ndryshme, me një të përbashkët: kundërshtimin dhe mohimin e botëkuptimeve dhe të normave të mirëpranuara në shekuj. Mohimet e shumëllojshme i japin heroit një tipar paradoksal. Meqenëse ato mendime nuk u përhapën, për mungesën e perspektivës, në kontekstin e vet historik letrar, heroi dhe romani nuk e fituan dot statusin e mirëfilltë të llojit paradoksal. Sidoqoftë, kishte një zanafillë dhe përpjekje për ta arritur shkallaren e tij të lartë.

Me përsiatjet dhe debatin e vazhdueshëm, struktura e tij parësore është struktura e romanit-tezë. Mirëpo, kompozicioni i lidhur nëpërmjet teknikës së ditarit është një nga kompozicionet më dalluese të romanit sentimental, që ka pasur problem qendror dashurinë dhe martesën e lirë, pa ndarje e paragjykime klasore. Heroi i tij, Gjon Zaveri, viktimë e mjedisit patriarkal, që i detyron martesën sipas moralit të vjetër, është i ngjashëm me heronjtë homologë sentimentalistë. Letra e fundit, testament, si shenjë paratekstore është ndërfitur te një nga veprat më të njohura të këtij lloji, *Vuajtjet e djaloshit Verter* të Gëtes, duke bërë ndërlidhjen letrare. Veprimi i tij është i ngjashëm me të Verterit, i cili lë të hapur në tryezë dramën *Emilia Galoti* të Lesingut, ku Emilia vret veten. Afritë, ngjashmëritë dhe ndërlidhjet janë dytësore. Në thelbin e mendimit, romani dhe heroi i Spasses janë në kundërshtim me romanin dhe heroin e Gëtes. Ndryshe nga Verteri, që vetëvritet për dashurinë pa fat, Gjon Zaveri vetëvritet jo vetëm se nuk e gjeti dot, por, edhe se

¹ Vangjel Koça, *Në udhën e shqiptarizmsë*, Phoenix, 1999, Tiranë, faqe 179-186// *Illyria*, 1935, nr. 26, 12 tetor; nr. 27, 19 tetor.

ishte i bindur, që nuk ka e nuk mund të ketë dashuri. Ajo për të është autosugestion, përzjerje e interesit lëndor me seksin shtazarak. Prandaj, fundin e Verterit e ironizon me cinizëm.

Gjithsesi, *Pse?! është fryt i mjedisit kulturor të kohës, kur lexoheshin dhe kishin filluar të përktheheshin filozofi, teori shoqërore, shkrimtarë të mëdhenj botërorë, nëpërmjet të cilëve intelektualët veprues, ndër ta dhe Sterjo Spasse, dëshironin të emanciponin shoqërinë shqiptare. Brenda e tij e ndërlikuar përplot me kundërthënie është përcaktuar, së pari, nga bindja përjashtimore e autorit kundër martesës, i ndikuar nga Leon Tolstoi, Artur Shopenhauer, Fridrih Niçe, etj. Në *Ditarin* e vet, ai pohon: "... kam qenë gjithnjë kundra martesës, edhe tashti që u martuash, jam po me ato mendime"¹. Me gjithë bindjen e tij, i detyruar nga familja, që e kishte fejuar në moshën 16 vjeç, përfundon i martuar. "*Jam fejuar më 12 gusht 1928. Atëherë unë ishqem 16 vjeç, kurse e fejuemja e eme... 15 e gjysëm. Jam fejuar më tepër me dashjen e prindërve se sa me dëshirën time...*"². Vetë autori është i dyzuar. Është kundër martesës, njëkohësisht gruan e do, dhe paradoksalisht shton: "*Megjithatë, nusen time e due, pra jam i lidhur shpirtërisht me të*"³. Ka edhe një lloj narcizmi, pëlqimi të tepruar të vetes, të cilin duke e trashur, ia ka mbingarkuar heroit.⁴ Ai ishte një djalë dhe burrë i bukur, që binte në sy menjëherë me shtatin e lartë, fytyrën e bardhë, tipare të rregullta si në skulpturë, sytë veçanërisht, me floknajën dredha-dredha dhe mirësjelljen dalluese. "*Brenda vitit, e përshkruan i biri, Ilindeni, ai kishte hedhur mjaft shtat: flokët e zez dredha-dredha, ata sy të thellë, ai ballë i gjerë, ato faqe të lëmuara dhe ajo freski rinore i joshi aq shumë motrat dhe nusen e Stojani... sa që nuk i shqiteshin së pyeturi për shkollën, për Elbasanin, për shokët...*"⁵ ... Dhe më tej: "*Tani më i rritur, më i mbushur, me një shtat më të lartë, me atë fytyrë mjaft simpatike, që zbukurohej nga leshrat e gjatë, të dredhura e të zeza*"⁶.*

¹ Ilinden Spasse, *Im atë, Sterjo!*, Tiranë, 1995, faqe 62.

² Ilinden Spasse, *Im atë, Sterjo!*, Tiranë, 1995, faqe 34-35.

³ Po aty, faqe faqe 62.

⁴ Dhurata Shehri, *Romani Pse?! ose erosi i estetizuar*, në *Studime Albanologjike, Erotizmi në letërsinë shqiptare*, 2011/2, faqe 118-122

⁵ Ilinden Spasse, *Im atë, Sterjo!*, Tiranë, 1995, faqe 30.

⁶ Po aty, faqe 68.

Në familje dhe në fshat ishte përjashtim. Djali i parë i shkolluar, që jeton dhe vjen nga qyteti, i ditur, me veshje qytetare, natyrisht, më mbresëlënëse. Në shkollë ishte i lavdëruar për inteligjencë, kulturë, edukatë, në rrethe intelektuale e shoqërore i çmuar për shkrimet. Sterjo Spasse kishte pse të vetëpëlqehej, pra, kishte mundësi narcizmi. Krahasimi i disa copëzave të përshkrimit të portreteve të jashtme nxjerr qartas në pah mbartjen e cilësive nga autori te heroit. Që në paraqitjen e parë heroit e përshkruan veten, kështu: *“Jam njëzet e dy vjet: tamam një njeri i shkathët, i fuqishëm dhe i pashëm pothuaj shumë. Kam bërë shumë udhëtime dhe jam takuar me shumë femra. Vajza të bukura dhe tërheqse kanë shijuar sytë e mij, por asnjë s’më ka hyrë në zemër... s’kam dashuruar. Çdo gjë e kam marrë për asgjë”*¹. Krenaria vjen nga ndjesi epërsie. Largimi nga femrat është veprim për të mbetur vetëm e për t’u dashuruar me veten.

Fshatarët e mbiçmojnë. Fejesa e tij, që është “hylli i katundit”, me një fshatare është nder, sepse me bukurinë dhe shkollën që ka mund t’i përbuzte vajzat e fshatit. Mbivlerësimi dhe adhurimi shprehet më fort te dëshpërimi i vajzave, që nuk patën fatin të martoheshin me të.

Përshkrimi i mikut të afërt, Gjençit, pasionant i bukurisë femërore, hedh më tepër dritë mbi mundësitë narciste: *“Me atë trup të bukur, të gjatë e të drejtë; me ata dy sy melankolikë, që shohin si shigjeta e që përvetësojnë aty për aty, me atë fytyrë aq tërheqse, me ato flokë kaçurrela, që të shtrihen aq hijshëm mbi krye porsì shtresa mëndafshi i dorës së parë... dhe me atë veshje të hijshme... a nuk thua i ke marrosur vajzat?”*².

Realiteti shqiptar i prapambetur, të cilin intelektualët dëshironin ta ndryshonin, për të qenë në mirëkuptim dhe të sendërtonin në të dhuntitë e tyre, nuk ndryshon, për më keq, ata, duke qenë të paaftë të dalin prej tij, bien viktima. Zhgënjimi i përgjithshëm, tanimë, dhe zhgënjimi vetjak që i ra në kokë me dasmën më 30 korrik, 1933, nuk mund të kalonin pa pasoja, pse jo traumë, apo depresion. Romani është shkruar në gjendjen mendore e shpirtërore para dhe pas dasmës, 7 maj 1933-25 nëntor 1933, pikërisht, në ndërkohën e ndeshjes më të madhe të bindjes vetjake dhe

¹ Po aty, faqe 10.

² Po aty, faqe 57.

lirisë, që kërkon të ketë shkrimtari i ri, me realitetin, konkretisht, me ndodhinë festive zakonore, që e futi edhe atë në vorbullën e martesës së papranueshme prej tij. Prandaj, në të, ku janë ndërfitur të dhëna e gjendje biografike, ka mendime kundërthënëse, pesimizëm e dëshpërim, mospranime e mohime vetjake të botëkuptimeve e të moralit në shekuj, interpretime negativizuese për dukuri qenësore/ekzistenciale të jetës njerëzore dhe të vetë njeriut.

Historia e rrëfyer prej tij fillon me pyetjen *pse?* dhe vazhdon me një sistem *pse*-shë me përgjigjet përkatëse duke thurur një strukturë dialogjike me biseda e debat të drejtpërdrejtë, e cila është zotëruese. Edhe përsiatjet monologjike, në ditar, shpesh janë dialogë të brendshëm, të tërthortë, arsyetime për të paraqitur të gabuara mendimet e të tjerëve. Për të provuar mungesën e dashurisë, rrjedha e gjatë e përsiatjeve dhe e debateve nëpërshton në disa histori dashurie: me zonjën P., me Polën, fejesa dhe martesë e tij në fshat, historia e Gjençit, të cilat i japin dinamizëm dhe këndshmëri rrëfimit.

Heroi, Gjon Zaveri mbeti pa të dytë në letërsinë shqipe. Tek ai janë mbartur zhgënjimi, thyerjet dhe dyzimet e autorit, të cilave u janë bashkëngjitur zhgënjime, thyerje e dyzime të tjera, disa të njëmendta e disa të panjëmendta, të sajuara, subjektive dhe të papërligjura. Ai, që zgjedh vetminë për të shpëtuar prej mjedisit shoqëror shqetësues, për të pa kuptim e funksion, mishëron intelektualin e zhgënjyer, një tipar jetësor historik, i sendërtuar me art. Po ashtu, është edhe tipar biografik i autorit, i zhgënjyer nga palëvizshmëria e shoqërisë, sidomos nga martesë e detyruar. Edhe kundërshtimi dhe mohimi, prejardhje të zhgënjimit, është tipar i njëmendët historik. Skajshmëria, absolutizimi i tyre janë grotesk i papërligjur, i sajuar prej autorit.

“S’di se si: zemra më vuan keq pa ditur ‘pse’-në, kurse truri pyet dhe përcjell pa pra mendime... mendime dhe asgjë tjetër. Sa krijesa- të mëdha e të vogla, të dukura e të padukura- ka natyra mbarë, aq pyetje të vijnë pa dashur në tru. Edhe gjëja më e vogël, më e pa dalluar të le mbresë: të bën që të pyesësh veten edhe t’i përgjigjesh po vetes”¹. Që në paraqitjen e parë heroi shfaqet në disharmoni me veten. Zemra dhe

¹ Sterjo Spasse, *Pse?!*, roman, botimi i gjashtë, *Ardita*, Tiranë, 1995, faqe 3.

truri, ndjenjat dhe mendimi janë në disharmoni/mospërputhje. Zemra vuan keq, se truri nuk u përgjigjet pse-ve. Qenia e tij jeton përmes trurit-mendimit, që punon pa pushim. Asaj i mungon veprimi, jeta e gjallë. Përgjigjet i kërkon te vetja, jo te të tjerët, te përvoja e tij, jo te përvoja njerëzore, as te shkencat e teologjia, shenjë e një shkallareje të lartë egocentrizmi. Përgjigjet janë të njëllota, paradoksale, mohuese, negativizuese të gjithçkaje që kalon në interpretimin e tij.

Thyerja e dyzimi midis ndjeshmërisë dhe mendimit përshkon një pjesë të qenies së tij. Ai e zbulon bukurinë femërore, e ndien, por nuk e pranon me arsyetime sofistike, sepse à priori ka parashtruar mohimin negativizues të tyre, të cilin e ndjek në mënyrë obsesive. Përshkrimi i hireve dhe i sjelljeve të Polës i jep kënaqësi, i ngjall emocione, ndonëse, shprehet, se për të është e huaj, ose e do si motër, dhe paradoksalisht, do të martohej me të, nëse nuk do të ishte fejuar. Përballja e ndjeshmërisë për Polën qytetare, të emancipuar e të bukur, me fjalën e dhënë për të fejuarën, fshatare, të pashkolluar, me sjellje e veshje tradicionale, i shkakton një krizë gjatë të cilës copëton kravatën, dhuratë nga Pola. Copëtimi i kravatës simbolizon shkëputjen prej qytetit, emancipimit dhe nënshtrimin ndaj traditës, kthimin drejt fshatit.

Pas disharmonisë së brendshme, me veten, shpërfaqet disharmonia me botën, me jetën, lindjen, martesën, me kulturën, veçanërisht me filozofinë.

1. Jeta është kotësi, sepse njeriu nuk di pse jeton. Për të, si të jetë, edhe mos të jetë i gjallë është njëllot, prandaj, në vend që t'i falet asaj për kënaqësitë, siç bëjnë njerëzia, ai tallet. “... të falem ironikisht, o Jetë! Jam - s'jam = qenka një për mua!”¹

2. Filozofisë nuk do t'i dëgjojë zërin, ndërkohë që vet, vazhdimisht mendon e përsiat dhe kërkon të gjejë shpjegime. “*Filozofia është gënjeshtër; rrenë..., që nuk më hyn në punë.*”²

3. Femra është hipokrite, pa inteligjencë, e dobët, i jepet shpejt mashkullit. Cinizmi i Gjon Zaverit për heronjtë e vetëvrarë të dashurisë, për femrën, shkon më tej, kalon në mizogjini. “*Sa hipokrite më duket*

¹ Po aty, faqe 6.

² Po aty, faqe 5.

se është femra!” ; “... në drej shkofshin femrat; jeta ime praktike, jeta e njerëzve me zë dhe prova e përditshme më kanë treguar fare mirë se s’paska femër me mend; të gjitha janë budallaçka e vetëm me dy tri fjalë të bukura i bën për vete. Ç’dobësi ndjenjore! Ç’marrëzi pa fund i sundon!”¹

4. Dashurinë e përjashton, se është dashuri interesi lëndor, iluzion. Ajo është robërim nga vetvetja, mynxyrë për veten dhe krijesa të tjera të pafajshme. “Unë kurrë s’kam dashur dhe as që dua femër.”; “... dashuri interesi, dashuri napolonash... dashuri = interes!”²

5. Martesa është skëterrë. “Mbas martesës fillon vallja e skëterrës...”³

Disharmonia e plotë e shtyn tej shoqërisë, tej familjes, në vetmi, ku ndihet i lirë dhe i qetë nga shqetësimet e botës dhe të kujtdo. “Kështu i vetmuar jam i lirë të mendoj... Oh! vetmi = lumturi për mua... jetë për mua!”⁴

Me tërë këto moskuptime e keqkuptime qeniesore/ekzistenciale, për të shpëtuar, i jep fund jetës. Në formën e një aforizmi dëshpërues, ato janë përmbledhur në fjalët e shkruara te koka e varrit, sipas porosisë së tij:

*Bota e Hiçit, prej Hiçit, për Hiçin,
Rrotullohet rreth qëllimit të Hiçit!*⁵

Zëvendësimi i të dhënave themelore: emër, mbiemër, vitet e jetës, me përfundimin e tij të gabuar për qeniesinë/ekzistencën njerëzore është ndëshkimi i merituar i njeriut pa identitet, pa vlerë shoqërore dhe vetjake.

Në disa breza lexuesish, që prej viteve 1930, kur doli romani, nga ata që e kishin lexuar dhe nga ata që nuk e kishin lexuar, në qytet dhe në fshat, është përdorur shprehja “Pse-në nuk e ka gjetur dot Sterjo

¹ Po aty, faqe 63, 64.

² Po aty, faqe 10, 30.

³ Po aty, faqe 55.

⁴ Po aty, faqe 15.

⁵ Po aty, faqe 179.

Spasseja”, duke e ngritur në shkallaren e shkrimtarit filozof, që ka marrë përsipër të shpjegojë fshehtësi të pakuptuara të jetës e të njeriut.

* * *

Ata nuk ishin vetëm (1948-1952), *Afërdita përsëri në fshat* (1955), *Buzë liqenit* (1965), *Zjarre* (1972) kanë luajtur një rol të ndjeshëm në formësimin e romanit të realizmit socialist. Ndër më të propaganduarit ka qenë *Ata nuk ishin vetëm*.

Ata nuk ishin vetëm

Problemet, rrethanat dhe personazhet i referohen fshatit të viteve 1930 të shekullit XX. Titulli dhe krejt lënda janë me ideologji klasore. Ata, fshatarët e varfër, nuk ishin vetëm. Me ta, ishin edhe punëtorët e qytetit, të vetëdijshëm se varfëria dhe padrejtësia shoqërore vinin nga sistemi feudo-borgjez. Rrugëndriçues për ta hequr atë qafe me dhunë të tipit leninist ishin komunistët, të cilët edhe historikisht, sapo kishin nisur veprimtarinë e tyre në Korçë. Dy-tri personazhe shqiptojnë drejtpërdrejtë idenë e solidarizimit ndërkombëtar, duke përmendur me admirim edhe shembullin e sistemit bolshevik. Rrëfimi është horizontal, njoftues, propagandistik, për një lexues me kulturë letrare fillestare, jo rrallë i ngjashëm me historitë e treguara nën rrapin e fshatit, ndodhur diku e dikur. Veprimi është i përqendruar në një konflikt interesash ekonomike dhe shoqërore të skajshme, që ashpërsohet vazhdimisht, midis heroit, Gjikë Shpati, shëmbëlltyrave të tjera mishëruese të fshatarëve të varfër, dhe antagonistëve, mishëruesit të beut e të fshatarit të pasur. Nga përgjumja, nënshtrimi ndaj padrejtësive, me fjalën ndriçuese të Aliut, shëmbëlltyrë idealizuese e komunistit Ali Kelmendi, i njohur historikisht i tillë, menjëherë kalohet në pakënaqësi, në kundërshtim të urdhrave të beut, mosshlyerje të detyrimeve ligjore, në revoltë, që përfundon në ndeshje fizike me xhandarët, një lloj kryengritje popullore. Fjalët: *shtypje, urrëjtje, përmbysje, kur të vijë dita jonë*, shoqëruar me bëma e gjeste, përdoren nga personazhet dhe rrëfimtari për antagonistët. Për të qenë i pëlqyeshëm nga heroit Gjikë Shpati, përcjellës i luftës klasore, dhe për të ndjekur porosinë e komunistit për të luftuar me çdo mënyrë të pasurit, një pasues i tyre dhunon të vjehrrin përpara fshatit, duke shkelur mbi dashurinë. Personazhet, në ndarjen e pakapërcyeshme në

mishërues të fshatarëve të varfër dhe të shtresave të pasura, janë, gati, të padallueshëm nga njëri-tjetri, pa botë të brendshme, nuk përsiatin, u mungon karakterizimi psikologjik dhe mendësor. Pozitivizmi i tyre është varfëria, vuajtja, urrejtja ndaj të pasurve. Për t’i bërë ato sa më të dukshme u janë veshur veprime ndryshe nga e vërteta historike, p.sh., ideja dhe sabotimi ekonomik, organizimi i bujqve për t’u përballur me beun, djegia e kullës së tij. Në të kundërt, negativizmi është pasuria, pangopshmëria në zhvatjen e mundit të bujqve, kënaqja pa kufi e dëshirave, deri në krim, degjenerimi moral, përbuzja ndaj të varfërve. Karakterizimi realist, ngjashëm me tipat e njëmendët të realitetit, është zëvendësuar, në një masë, me epitetizimin, shenjë thjeshtëzuese e tij. Epitetizimi idealizues është për personazhet pozitive. Djemtë cilësohen *trima*, vajzat *sorkadhe*. Gjika, individualizohet me llogapin Shpati, sepse me guxim dhe arsye, e ndan si me shpatë të mirën nga e keqja. Quhet *kapedan*, ka gojë që *të magjeps*. “Gjikës i ziente kraharori si *vullkan*. Fjalët i nxori nga goja si *bubullima vjeshte*. Nga fytyra ishte skuqur, sytë i *xixëllonin*, mjekra i dridhej dhe zemra i rrihte fort. Në dorë shtrëngonte bishtin e *sëpatës*, thujaje mbante *revolen gati për të qëlluar*... Për të parën herë e ndjeu veten *luan!*”¹

Epitetizimi karikaturizues është për personazhet negative. Kapllan beu për fshatarët është “*i paudhi*”, qehajai i tij, Kara Mustafai “*Lugati*”. Portretizimi i jashtëm i tij përfton shëmbëlltyrë lugati: “Kara Mustafai është i gjatë, me shpatulla të gjera, me *mustaqe deri te veshi*, me hundë *të madhe dhe të kthyer si samar*, me sy që vështrojnë *vëngër*, me gojë *si çorape* dhe me dy dhëmbë, që i rrinë jashtë e që duken *si dy çengela*. Kur flet, bashkë me fjalët, nga goja *kutërbon një erë e keqe*, një erë që *të zë frymën*”². Rako Ferra i kap fshatarët me fajdenë e borxheve si ferra dhe nuk i lëshon. Edhe portreti i tij është hiperbolik, me parregullsi fizike, dinakëri me fshatarët, përrulje neveritëse para beut, madje dhe rojës së tij: “... endej poshtë e lart, i shqetësuar dhe i hutuar. I shkurtër si *shebek*, me kokë të madhe si *shinik*, me duar të gjata si *majmun*, e

¹ Sterjo Spasse, *Vepra Letrare 3, Ata nuk ishin vetëm*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1980, faqe 35.

² Po aty, faqe 64.

gjeje kudo dhe kurdoherë duke vështuar me *dhëlpëri...*”¹; “Edhe kur nxirrte fjalë nga goja, edhe kur bënte shenja, dukej sikur *lëpinte* diçka, sikur *lëpinte këmbët e Lugatit*”².

Brendia ideologjike, e ndërftuar me dorë të lirë, kompozicioni i konfliktit klasor bardhezi, më tepër i sajuar, sesa i mbështetur në njëmendësi historike, personazhet e paramenduara, ilustruese të ideve të caktuara e jomishëruese të tipave të asaj periudhe, ishin konkretizim shabllon i kërkesave të metodës së realizmit socialist. Më mbresëlënëse janë përshkrimet e jetesës, traditës, punëve bujqësore e të natyrës së fshatrave të Prespës prej nga ishte autori, si dhe karakterizimi me doza realiste i nja dy personazheve. Në shtratin e prokrustit të metodës së realizmit socialist janë shpërbërë cilësitë e stilit të prozës së Sterjo Spases, që kishin spikatur te “*Pse?!*”, vetvetishmëria e të shprehurit, deri në kufijtë e çdrejtimit, karakterizimi realist dhe analiza psikologjike e personazheve, përshkrimi me vërtetësi i mjedisëve në funksion të zbulimit të tyre.

* * *

Cikli i romaneve *Rilindasit*, me tematika nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe lufta për pavarësi, i përbërë nga *Zgjimi* (1973), *Pishtarë* (1975), *Ja vdekje, ja liri* (1978), *Kryengritësit* (1983), *O sot, o kurrë!* (1989), është afresku më i shtrirë në kohë dhe në hapësirë i romanit historik romantik shqiptar. Me disa elipsa kohore nëpërshkon vitet 1885-1887; 1897-1907; 1910-1911; maj, 1912 - gusht, 1912; tetor, 1912 - nëntor, 1912. Po ashtu, edhe gjeografikisht, veprimi zhvendoset nga Korça e rrethina, në malësi të Pogradecit, në Negovan, Manastir, Shkodër, Malësi e Madhe, Tuz e Deçiq, Gjakovë, Pejë, Junik, Prishtinë, Shkup, Fier, Vlorë, etj., vende ku janë zhvilluar ngjarje të shënuara. Herë me ngjyra realiste dhe herë, me ngjyra të theksuara romantike, poetizuese e legjendare, shoqëruar me patos pohues dhe mohues, janë shëmbëllyer një sërë figurash historike, pjesëmarrëse në këto ngjarje kombëtare, në konflikt dramatik me veten, me pushtuesin turk,

¹ Po aty, faqe 27.

² Po aty, faqe 120.

turqizimin dhe greqizimin. Themistokli Gërmenji - Misto Gërmenji, Jovan Cico Kosturi - Xhaxha Vani, Thimi Marko, Orhan Ç. Pojani, Papa Kristo Negovani, Bajo Topulli, Dedë Gjo Luli, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Hasan Prishtina, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi dhe figura të tjera historike prej të cilave disa janë me portret të plotë e vërtetësi, me botëkuptim e të dhëna psiko-morale të njëmendta, disa të karakterizuara pjesërisht, pa arritur në një tërësi tiparesh harmonike, disa të përvijuara sipërfaqësisht, pa botë të brendshme, me veprime e bëma të jashtme, jobindëse.

Zgjimi

Poetika e romanit të tij historik romantik, në shkallaren më të lartë, është te *Zgjimi*, i strukturuar sipas gjedhjes klasike të Valter Skotit, që rrëfen për traditat kombëtare, të kaluarën e lavdishme, apo heroike nëpërmjet ngjarjeve të mëdha, figurave historike, legjendare e popullore.

Është romani i parë që i referohet periudhës së rëndësishme të zgjimit të vetëdijes të të qenët shqiptar, lëvizjes për përdorimin e shkrimkëndimit dhe hapjen e shkollave shqipe, në vitet 1885-1887 të Rilindjes Kombëtare. Kthimi në histori, në një periudhë të pajetuar prej autorit, për cilindo ka vështirësi. Megjithatë, për shkrimtarët e brezit të Sterjo Spasses ishte më e lehtë edhe për vetë jetën e tyre, që niste në fillim të shekullit XX. Duke qenë afër saj, ka qenë i lidhur drejtpërdrejt me disa mësues, shkrimtarë, figura historike, të ardhur gjallë nga Rilindja, bartës të kujtimeve dhe të përjetimeve burimore.

Hapësira e zgjedhur e zhvillimit të ngjarjeve dhe ndodhive, Korça, ka qenë mjaft e përshtatshme për të shëmbëllyer botën letrare në ngjashmëri me të vërtetat, sepse historikisht, në atdhe, ka qenë qendra e asaj lëvizjeje. Sterjo Spasseja, i lindur në një fshat të saj, ishte njohës i atyre traditave, mënyrës së jetesës, mendësive, urbanistikës, klasave dhe shtresave shoqërore, të cilat ishin ruajtur ende në bashkëkohësinë e tij. Përmbi këto mundësi vetjake ishte përvoja dhjetëravjeçare, laboratorit krijues i mirëpajisur dhe mjeshtëria e përpunuar, që arriti kulmin te *Zgjimi*.

Në të, sikurse është në poetikën e llojit të romanit historik romantik, përparësi kanë ngjarjet dhe ndodhitë e shumta, të njëpasnjëshme, deri diku aventurore, të cilat shkakësohen nga konflikte tepër të ndërlikuara, që kanë pasë përballuar njëmendësisht shqiptarët.

Konflikti ndëretnik mes shqiptarizmit dhe greqizmit, nga njëra anë, dhe

shqiptarizmit dhe turqizmit, nga ana tjetër, ka marrë ngjyrat e ndezura të konfliktit ndërfitar mes ortodoksizmit, të ndërsyer nga kisha e shkolla greke, dhe myslimanizmit, nën mbrojtjen e pushtetit sulltanor dhe të fanatikëve të tij. Për interesa ekonomike, vartësi fetare, kulturore, psikologjike, sidomos nga mungesa e vetëdijes kombëtare, aktorë veprues në lojën e politikës së tyre janë edhe kategori të caktuara shqiptarësh. Fijet e veprimit, krahas në disa linja, nëpërshkojnë në këtë labirint konfliktesh dramatike, në trajta dhe shkallare të ndryshme, të cilat pak nga pak, prej thellësive të vetëdijes e prapaskenave dalin në sipërfaqe dhe në skenë. Ndryshueshmëria, zgjimi e formësimi i vetëdijes së të qenët shqiptar te shëmbëlltyrat e brezit të adoleshentëve, nis në formën e konfliktit të brendshëm, psikologjik, me dyshim e frikë, me dyzime në mendime e qëndrime, pyetje, pikëpyetje deri në përgjigjen e vendosur, që i shtyn në veprim.

Sistemi i përligjjes shkak-pasojë është i vijueshëm. Ngjarjet dhe personazhet janë në marrëdhënie funksionesh të anasjella. Ngjarjet zgjojnë e ndryshojnë personazhet. Bëmat e personazheve përftojnë ngjarje të reja. Lidhja e ndërlidhja e atdhetarëve prej kurbetit, Rumanisë e Stambollit, në Korçë, Mokër e Gorë, ndryshon rrethanat e zgjidhjes së tyre, ndonëse, tej të tanishmes, në ardhmërinë e afërt. Edhe propaganda atdhetare me stafetën e *Alfabetares/Abetares*, që nëpërmjet marrëdhënieve miqësore e familjare, kalon fshehtas nga kthinat e shtëpive te dyqanet, në fazën dramatike shfaqet haptas, në orët e mësimin në gjimnazin grek, në festa shoqërore, në mbledhjen e dhimogjerondisë së mitropolisë dhe në mexhlisi - idarenë/mbledhjen e Këshillit Administrativ të qytetit. Përballja e mendimeve kalon në qëndrime të kundërta të drejtpërdrejta, dhe prej tyre, në organizimin e ndeshjeve të hapëta. Mitropoliti, Fillothe, koka e greqizmit, sulmohet nga kaçakët, ndërsa, shpërndarësi i *Alfabetares/Abetares* dhe i shkrimkëndimit shqip, Gjokë Mokrari, i quajtur, Gjokë Shqiptari, digjet me vajguri nga Sefedin agai me sejmënët e tij.

Por, gjedhja skotiane, me thelbin e vet ideologjik kombëtarist, është kryqëzuar me kërkesën e metodës së realizmit socialist të luftës klasore, përkatësisht, në botën shqiptare, mes fshatarësisë së varfër, punëtorëve të krahut, zanatçinjeve e zejtarëve me aganë, beun, tregtarët e pasur. Disa personazhe, mishëruese të klasave të varfra, shqiptojnë ligjëratat për shtypjen dhe shfrytëzimin prej agait dhe beut, mungesën e drejtësisë shoqërore, diku ngjashëm me personazhet e romanit *Ata nuk ishin vetëm*, duke shkuar përpara në kohë, në procesin historik të viteve 1930 të

shekullit XX. Qëndrime të tilla klasore shpreh edhe rrëfimtari-autor me ndërhyrjet poetizuese për personazhet, që mishërojnë atdhetarizmin dhe shtresat e varfra, dhe karikaturizuese për ata që mishërojnë grekomanët, turkomanët dhe shtresat e pasura.

Personazhet kanë shkakësim/motivim të jashtëm prej mjedisit e rrethanave, dhe po ashtu, shkakësim/motivim të brendshëm, botëkuptimor, psiko-moral, ndjenjësor. Ndryshimi botëkuptimor e psikologjik te heroi, Misto Gërmenji, shëmbëlltyrë e të mirënjohurit në histori, Themistokli Gërmenjit, shkakësohet njëherësh prej ndjenjave, botëkuptimit, moralit. Nxënësin e shkëlqyer të gjimnazit grek, i pasionuar pas kulturës së lashtë, me shpresë për të studiuar me bursë shtetërore në Athinë, letra e shkruar në shqip, që i vjen prej të atit dhe porosia e tij, e nxisin të mësojë shkrim-këndimin shqip. Xhaxha Vani, mik i të atit, e përcjell të marrë *Alfabetaren* te Marga për të cilën ka ndjesi dashurore. *Alfabetarja* dhe të mësuarit e shkrim-këndimit merr fytyrën e saj. Mirëbesimi dhe bindja ndaj porosisë së të atit, atdhetarizmi dhe mirësia e xhaxha Vanit, dëshira për të mësuar shkrim-këndimin shqip, e pandarë nga ndjesia dashurore për Margën, të shkrira në një, i shndërrojnë vështrimin ndaj botës, shkollës, njerëzve. Atëherë, vëren mospërputhjet mes jetës dhe propagandës greqizuese e turqizuese. Në shkollë e në kishë ortodoksët flasin e dëgjojnë greqisht, dhe u thonë se janë grekë. Fëmijët myslimanë, në shkollë mësojnë turqisht, dhe u thonë se janë turq. Në familje, me të afërm e miq, gjithë qyteti flet shqip, e cila në shkollë nuk lejohet. Edhe hapi tjetër i zhvillimit të tij, lidhja me kaçakët, është i përligjur moralisht dhe botëkuptimisht. Ai, që tmerrohej edhe nga ideja e afrimit të kaçakut në qytet, papritur është i detyruar ta ndihmojë, sepse i ka dhënë besën mikut të të atit, përhapësit të *Alfabetares*, Gjokë Shqiptarit, para se të marrë vesh se çfarë do t'i kërkojë ai për dhëndrin e vet. Kundër dëshirës, natyrës e botëkuptimit paqësor, në emër të besës bëhet kallauz i kaçakut, që gjurmon për të vlarë Sefedin again dhe mitropolitin Fillothe. Mirëpo, kur mëson, se ata me babëzitë dhe pamoralshmërinë e tyre, i kanë shkatërruar jetën, të shoqen dhe familjen, se kanë djegur me vajguri, Gjokë Shqiptarin, vrasja e tyre nuk i duket e tmerrshme dhe as e padrejtë. Me këtë bindje e ndihmon me vetëdije.

Mendësitë, sjelljet, bëmat e disa personazheve të tjera, shëmbëlltyra të paratipave të asaj kohe, përligjen, gjithashtu, me gjendjen e tyre shoqërore, botëkuptimin, moralin e ndjeshmëri njerëzore të njëmendta. Primitivizmi, egërsia e kaçakut Marko, papërmbajtshmëria në ndjenjën

e hakmarrjes janë pasoja të prapambetjes, varfërisë, padrejtësive shoqërore e klerikale. Padurimi i Lenës për t'ia dhënë të bijën, Margën, për nuse, birit të Kondurajve, përlësia ndaj tyre, mburrja, se ka krushqi me tregtarët më të pasur vijnë prej vartësisë psikologjike të të varfrit pa dinjitet përpara cilitdo të pasur. Ngulmimi, gati prej të sëmuri, i Petraq Kondurit për ta pasur për grua Margën, një vajzë të shtresës së varfër, është shprehje e prepotencës, e ushqyer nga mendësia, se atij, të pasurit, i takon me doemos ta ketë të vetën edhe vajzën më të bukur. Gjikë Mokrari është portretizuar me dy ngjyra të theksuara, kontrastuese-dramatike dhe poetizuese. Shëmbëlltyrë realiste e fshatarit të varfër atdhetar, me sakrificën sublime për përhapjen e shkrim-këndimit shqip, përkushtimin hiperbolik, vuajtjet dhe fundin tragjik të jashtëzakonshëm është ngritur në shkallare legjendare, lloj figure e njohur e romanit historik romantik.

Shkakësimi/motivimi i brendshëm i bëmave të disa personazheve është i pjesshëm, ndërsa shpesh nuk ka qenë qëllim i autorit, prandaj, veprimet e tyre janë të ngjitura, të panatyrshme, pa ndikim te rrethanat dhe ndodhitë. Përshkrimi dekorativ, dhe rrallë metonimik, i mjedisit të qytetit të Korçës, i fshatit malor, i mjediseve të brendshme, familjare, institucionale shtetërore, klerikale, profesionale, ndonëse, i shkurtër e i herëpashershëm, me të dhëna të njëmendta e hollësi të shumta, konkretizon një botë të tërë hapësinore, gjeografike, etnokulturore me përbashkësi, dallime e ndasi të mëdha, bazë e njësisë dhe e konflikteve të brendshme, që gjallojnë në jetën e tij politike shoqërore. Urbanistika e saj është e shtrirë, me lagjet, rrugët, rrugicat, emërtimet historike, sheshet, pazaret, dyqanet, farmacinë, studion e vetme fotografike, ndërtesat e institucioneve të pushtetit, hyqymetin, beledijen, burgun, metroplinë, manastirin, xhamitë, gjimnazin grek, etj., ku shtrihet veprimtaria e personazheve. Shtëpitë dhe mjediset e brendshme familjare janë të larmishme, të shtresave të varfra, të mesme e të pasura, në qytet dhe në fshat, me oborret karakteristike, dhomat e kthinat, orenditë, dekorin fetar sipas mënyrës së jetesës. Veshjet, shenjë e rëndësishme e kohës, e gjendjes ekonomike të atyre që i mbajnë, të burrave e të grave, të punëtorit të krahut, tregtarit të mesëm e të pasur, mitropolitit, qeveritarëve, të qytetareve të thjeshta, zonjave të pasura, fshatareve të varfra, janë përshkruar me hollësi, për lëndën, përmasat, ngjyrat, zbukurimet dalluese.

Shevqet Musaraj (1914-1986)

Shevqet Musaraj është lindur në Smokthinë (Vlorë), kreu *Shkollën Tregtare* të Vlorës. Ishte pjesëmarrës në luftën kundër fashizmit dhe drejtues i disa organeve të shtypit ilegal. Themelues dhe drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve, i angazhuar politikisht, në veprimtari dhe në letërsi, ka qenë besnik i realizmit socialist. Pamfleti poetiko-politik *Epopëja e Ballit Kombëtar* (1944), novela ironizuese *Isha unë Çobo Rrapushi* (1960) dhe romani *Para agimit*, në dy vëllime (1965, 1966) kanë qenë gjedhje përfaqësuese të realizmit socialist.

Isha unë Çobo Rrapushi

Në novelën *Isha unë Çobo Rrapushi* përmes vetërrëfimit të heroit, Çobo Rrapushi, ironizohet një dukuri e njëmendët, që u shfaq te disa kategori ish-partizanësh, pa arsim e kulturë politike, të ardhur në pushtet. Fitimtari e mendon veten bej e zotëri, të cilit do t'i vijnë të mirat pa punuar. Shevqet Musaraj e konkretizoi me periudhën e pasluftës, ndonëse, keqkuptimi dhe keqpërdorimi i pushtetit për dobi vetjake është një dukuri karakteristike shqiptare, që përhapet në përmasa e trajta të ndryshme sa herë ndërrohen sistemet politike dhe qeveritë. Por, e vërteta historike, që ka qenë e kapërthyer nga realiteti shoqëror i ideologjizuar, në novelë, është dhënë edhe në një këndvështrim të ideologjizuar. Çobo Rrapushi, shëmbëlltyrë realiste e fshatarit lab të ngjitur në pushtet, braktis punët e lodhshme të fshatit dhe shkon në Tiranë mes mirave të qytetit. Ironia dhe humori i vetërrëfimit, mbështetur gjerësisht në ironinë dhe humorin e ligjëritimit bisedor të Labërisë prej nga është, përftohet

prej kundërvënies së tij me traditën dhe shoqërinë e re socialiste. Kurse, historia e përmirësimit të tij në shkallaren e shembullit pozitiv për të tjerët ka dalë jashtë veçantisë së llojit, sepse pozitivizmi, harmonizimi me shoqërinë nuk mund të përftojë ironi e humor. Edhe vetironizimi, më tepër se zbulim i mbrapshtive të tij, është pohim i realitetit të ri shoqëror, me pronë të përbashkët e kooperativë, me drejtësi e mbrojtje për të varfrit. Madje, novela është e ideologjizuar në thelbin e saj, që ka përcaktuar edhe strukturën kompozicionale. Historia, që rrëfen për mbrapshtitë e veta, është shpalosje e letrarizuar e asaj që quhej *vetëkritikë bolshevike*. I gabuari ndreqet nën ndikimin edukativ të familjes e të mjedisit, sidomos i bindur nga mbarësitë ekonomike shoqërore.

Para agimit

Në fazën e formësimit të romanit të realizmit socialist, në vitet 1960-1970, shkrimtarët, tanimë, me kulturë e përvojë letrare më të madhe, shmangën disa dobësi thjeshtëzuese, të cilat nuk i pranonte as lexuesi. Për të qenë sa më ndikues, duke zgjeruar shtratin e tij realist me të dhëna jetësore, pasuruan edhe mënyrat e mjetet e karakterizimit të personazheve, pa e cenuar indin dhe strukturën e tërësishme ideologjizuese. *Para agimit*, i shkruar në këtë ndërkohë, u dallua, mes të tjerëve, për karakterizimin shoqëror, psiko-botëkuptimor, aty-këtu, edhe ndjenjësor, veçanërisht, për karakterizimin e tyre gjuhësor nëpërmjet të folurës popullore sipas përkatësisë krahinore e kulturore. Me të dhëna burimore dalluese, të marra nga paratipa të ndryshëm të jetës, janë portretizuar me vërtetësi disa personazhe bëmat e të cilëve janë të mirëshkakësuar nga bota e tyre e brendshme, nga mjedisi e rrethanat.

Vëllimi i parë, me historinë e rrëfyer dhe thurjen romanore, është tërheqës. Problemi ndërlihdës është qeniesor/ekzistencial, i njohur në letërsi të gjuhëve dhe kohëve të ndryshme: marrëdhëniet midis idealit dhe dashurisë, erosit. Te *Para agimit* interpretohen nga këndvështrimi i botëkuptimit komunist të skajshëm: ideali është mbi dashurinë, e cila nuk mund të ekzistojë jashtë dhe pa qenë në përputhje me të, në kundërvënie, kështu, me botëkuptimet e tjera liberale e sentimentale. Ndryshe nga *Qyteti i fundit* (1960) i Petro Markos, heroi i të cilit për

arsye të misionit largohet pa dëshirë e me dhembje nga dashuria, *Para agimit* ishte paradigmatic i atij botëkuptimi dhe morali asketik, që zotëruan jetën shoqërore, familjare, letrare dhe letërsinë e realizmit socialist për dyzet e pesë vjet. Shevqet Musaraj, i bindur se pohon një vlerë të re njerëzore, në të vërtetë, nëpërmjet tyre zbulon dramën tragjike të vetëvrasjes së dashurisë. Lexuesi i emancipuar, qoftë i djeshëm, aq më tepër i sotëm, e ka të vështirë ta pranojë, apo ta quaj njerëzore këtë lloj vetëvrasje, sepse edhe kur është e përligjur, është humbje e dhembje e madhe, të cilat heroi i tij nuk i ndien. Qemal Orhanaj, ende pa u shndërruar në hero pozitiv, dashuron vajzën e kulturuar, të një familjeje të pasur, Emira Velo. Ajo është edhe më e çiltër dhe e vetvetishme. E dashuron atë, edhe pse vjen nga shtresë e varfër, nuk ka arsimin dhe kulturën e saj. Në idilin e tyre përshkruhen me emocionalizëm gjendje dhe zbulohen ndjenja të holla. Ndjeshmëria, me sa duket, është përfutur edhe nga përjetimet vetjake të autorit, që pati një dashuri të tillë me një letrare të re dhe figurë politike femërore të asaj kohe, prej së cilës u largua jo pa dhembje. Konflikti ndarës shfaqet në pikëpamje dhe më pas, në qëndrime politike e klasore. Heroi për të ecur në rrugën e idealit e shpërfill dashurinë pa mëdyshje, në momente të caktuara edhe me përbuzje, ndërsa, heroina vuan për zbehjen e saj, përpiket të afrohet, dhe në pamundësi për ta ruajtur, vajton për të. Cili është njerëzor, ai apo ajo? Në këtë pikë, afërsisht në 200 faqe, përfundon drama, njëherësh, edhe letrarësia e romanit. Protagonisti pozitivizohet, duke u larguar prej dashurisë për një vajzë me pikëpamje e qëndrime politike të kundërta. Personazhe të tjera pozitivizohen, që tallen e qeshin gjatë gjykimit të mishëruesve të klasave armike, madje, nuk kanë asnjë rëndim psikologjik në dhënien e dënimit të tyre kapital. Ka dy mundësi. Ose ashpërsia e luftës, ideologjia klasore i kishte çnjerëzuar në jetë këta tipa, ose autori, për të rritur pozitivizmin e tyre, u ka dhënë nota të tilla. Qemal Orhanaj, në ilegalitet Zef Moisiu, që zotëron veprimin dhe mendimin e romanit, rrethohet e prapandiqet nga një sërë figurash ilegalësh, komunistë dhe jo komunistë, drejtues të celulave të partisë të lagjeve, udhëheqës të Komitetit Qarkor e të Komitetit Qendror. Dhe për t'u përmyllur krejt hierarkia partiake, në një trajtë mistifikuese, afrohet edhe udhëheqësi kryesor, Enver Hoxha, nëpërmjet adhurimit të atyre,

që dëgjojnë fjalimet në mbledhje, lexojnë shkresat dhe urdhrat e lëshuar prej tij me mençuri dhe drejtësi. Grupi tjetër i personazheve, mishëruesit e klasave të pushtetit të vjetër, të partive e qëndrimeve jokomuniste, të figurave historike të *Ballit Kombëtar*, *Legalitetit*, *Social-Demokrates*, janë në rënie e degjenerim, nën tryshninë e ankthit për ndëshkimet e pritshme, të lajmëruara nga fitimtarët.

Më tej, romani, veçanërisht vëllimi i dytë, vazhdon me përhapjen në shumë degëzime të linjës së luftës ilegale, polarizimit të shoqërisë shqiptare, nga bisedat e debatet miqësore, në mospajtime e përçarje politike, deri në ngritjen e kurtheve dhe ndeshjeve me armë. Rrëfimi i mirëfilltë letrar shpërbëhet nga mbivendosja e trajtave të tjera rrëfimore: kronika, informacioni politik dhe ushtarak, letra, ditari, që e shndërrojnë në një lloj historiku të letrarizuar të lëvizjes ilegale e komuniste dhe të veprimtarisë së bashkëpunëtorëve me nazizmin, parë në këndvështrimin e gazetarit, drejtuesit partiak të asaj kohe, më vonë të shkrimtarit të realizmit socialist.

Fatmir Gjata (1922-1989)

Fatmir Gjata është lindur në Korçë. Mori pjesë në luftën kundër pushtimit fashist e nazist. Kreu studimet e larta në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki*, në Moskë. Me *Përmbysja* (1954), *Këneta* (1959), *Këshilltarët* (1979) ka qenë një ndihmëtar tjetër i realizmit socialist. Më i njohuri dhe i përhershëm në programet shkollore ka qenë *Këneta*.

Këneta

Romani është mbështetur te ngjarja e njëmendët e tharjes së kënetës së Maliqit (Korçë, 1945/46), por e parë nga këndvështrimi ideologjik i realizmit socialist. Titulli ka domethënie metaforike. Rrëfimi për ngjarjen, në kontekstin e konfliktit dramatik, ka edhe domethënie e tharjes së “kënetës së armiqve” të grupit të inxhinierëve që përpiqen të pengojnë masën e vullnetarëve për ta kryer atë. Struktura shoqërore, që është struktura e zakonshme e romanit realist, është tjetërsuar në strukturë të veprimtarisë partiake. Ky ndryshim ka ardhur, sepse edhe në strukturën e re të shoqërisë, strumbullar është institucioni partiak. Veprimi fillon, zhvillohet dhe përfundon, duke pasur në qendër heroin pozitiv, Stavri Lara, mishërues i komunistit të përkushtuar në bindjet e tij. Ai është portretizuar së jashtmi, me bëmat në kohën e luftës partizane, dhe në të tanishmen, së brendshmi, në mendimet, ndjenjat, përjetimet, krahas në dy linja, të misionit politik e organizativ dhe të dashurisë me Rinën. Me tipare e bëma të besueshme, të qëmtuara në paratipa shoqërorë të atyre

viteve, me virtyte, dobësi e gabime, mbeti ndër figurat më të arrira të heroit pozitiv. Megjithëse, në kornizën e metodës së realizmit socialist, përmbytur nga ideologjia, në të ka pamje jete, të punës vullnetare, mjedise qytetare, atmosferë kohe të përshkruara me realizëm, me të dhëna dhe hollësi historike. Është nga romanet e rralla në të cilin disa figura komunistësh dhe të “armiqve”, veprojnë e shprehen, janë të shkakësuar/motivuar në përputhje me interesat shoqërore, formimin kulturor, mendësitë karakteristike, psikologjinë dalluese të paratipave shoqërorë, sidomos me rrethanat dramatike. Në rrethana të tilla, kur një palë, ish-partizanët, punëtorët e fshatarët kishin marrë pushtetin, dhe klasat e pasura, bejlerët, tregtarët, ish-politikanët, bashkëpunëtorë dhe jobashkëpunëtorë me pushtuesin, e kishin humbur, dhe me dhunë e nën dhunë, kishin ndërruar rolet shoqërore dhe ekonomike. Natyrisht, do të ketë konflikt të papajtueshëm, urrejtje dhe përbuzje ndaj njëra-tjetrës. Figurat e disa komunistëve, pa humbur epërsinë e rolit shoqëror, të bëmave dhe të virtyteve, kanë dobësi dhe vese. Drejtuesi politik më i lartë në rreth, Gjikë Dolani, i mbyllur në zyrë, dobësitë e punës së vet ua hedh të tjerëve. Aleks Mushi, ish-partizan, punonjës me përgjegjësi është imoral, tiran i së shoqes. Ky “guxim” kritik, i pazakonshëm ka qenë nxitur nga klima liberalizuese në Bashkimin Sovjetik në fundin e viteve 1950, e cila sado pak, erdhi, por nuk u përhap në letërsinë shqipe. Edhe veprimet kundërshtuese, “armiqësore” të figurave negative: Kujtim Shaqiri, Abdi Sharra, Vasil Minga, pavarësisht negativizimit të tepruar, herë-herë, vulgarizues, janë të përligjura me humbjen e pushtetit politik dhe ekonomik, terrorin shtetëror, përbuzjen e masave ndaj tyre. Inxhinieri Abdi Sharra, mishërim i intelektualit me formim perëndimor, duke parë fundin e mundshëm, hendekun midis vetes, shtresës së vet dhe turmës së indoktrinuar, kalon në një shndërrim psikologjik, nga frika prej terrorit, në veprime të fshehta kundërqëndruese. Feminizmi i personazhit të Zyraka Mingës, shija e hollë, përkujdesja në veshje, gjestet e çliruara nga ngurtësia e fanatizmit patriarkal, që shkrimtari i ka dhënë nga këndvështrimi i denigrimit klasor, dhe lexuesi i atëhershëm, i ka lexuar si sjellje të femrës borgjeze imorale, njëmendësisht, janë tipare të femrës së emancipuar, me mundësi ekonomike dhe kulturë

jetese. Bëma e tipare të tyre, të negativizuara nga këndvështrimi i luftës klasore, sot, në kontekstin shoqëror të mendimit e të veprimit të lirë, lexohen pozitive e të pozitivizuara.

Ali Abdihoxha (1929)

Ali Abdihoxha është lindur në Elbasan. Kreu *Shkollën Normale* të Elbasanit. Pjesëmarrës në luftën kundër pushtimit fashist e nazist. Ndoqi studimet e larta në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki* në Moskë.

Romanet *Një vjeshtë me stuhi* (1959), *Tri ngjyra të kohës* (1965-1972), në katër vëllime, *Vila në periferi* (1982), *Kronika e një nate* (1984), të konceptuara në shtratin e prokrustit të realizmit socialist, përveç ndihmesës në formësimin e trajtës së tij shqiptare, kanë ndikuar edhe në forcimin e realizmit, konkretisht, në zgjerimin e këndvështrimit ndaj jetës, në përpjekjet për karakterizimin dhe analizën psikologjike të personazheve.

Një vjeshtë me stuhi

Një vjeshtë me stuhi, e programit mësimor parauniversitar dhe universitar, ka për gjedhje ideore dhe strukturore romanin e Aleksandër Fadejevit *Garda e Re* (1943-1945, 1951), tepër i propaganduar në Lindjen staliniste. Ideja e luftës së rinisë komuniste shqiptare kundër nazizmit, qëndrueshmëria përballë torturave, prejardhja shoqërore, të dhëna njerëzore të disa tipave, marrëdhënie rinore dhe idealiste mes tyre, të zvogëluara nga talenti i kufizuar dhe mungesa e përvojës së këtij autori, janë të ngjashme me ato të romanit *Garda e Re*. Heronjtë pozitivë, Petrit Guraj dhe Lumto Gjinari, për të qenë sa më “heronj” të fjalëve përshkruhen superiorë, tej të mundshmes, jo vetëm ideologjikisht e moralisht, por edhe psikologjikisht e emocionalisht në debatet pas

torturave (!), njëri, përballë komandantit të gestapos, majorit Franc, dhe tjetra, përballë ish-shokut të shkollës, Nazmi bej Topit, komandant i *Ballit Kombëtar* në qytetin e ngjarjeve. Majori Franc, pas lloj-lloj përpjekjesh për ta nënshtruar heroin, Petrit Guraj, arrin t'i lutet për t'i treguar udhëheqësit e lëvizjes (!!). Shkak i zbulimit të veprimtarisë ilegale bëhet i ati i shokut të tyre, mishërim i tradhtisë për interesa vetjake, dhe i biri i tij, Qamil Tapia, mishërim i frikacakut, sikurse te *Garda e Re*, bëhet shkak tipi i frikacakut, Stahoviçi. Të dy tradhtarët, në gjendjen më të mjerueshme e të turpëruar, përfundojnë bashkë me shokët. Nga besnikëria për të qenë sa më afër me gjedhjen ideologjike, ka pasaktësi historike për veprimtarinë bashkëpunuese të *Ballit Kombëtar* me pushtuesit, simbolet që përdoren nga kundërfashistët, etj. Nuk mungojnë as skena e detaje plagjiature.

Dhimitër Xhuvani (1934-2009)

Dhimitër Xhuvani është lindur në Pogradec, kreu *Teknikumin Mjekësor*, studimet e larta në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në *Universitetin e Tiranës* dhe studime plotësuese në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki*, në Moskë.

Proza romanore prej pesëmbëdhjetë titujsh e Dhimitër Xhuvanit ka kaluar nga skaji i liberalizimit te skaji i konformizmit të thjeshtëzuar. E nisur me *Tuneli* (1966), i një realizmi “pa caqe”, nën goditjet e forta të kritikës tërhiqet e tkurret plotësisht brenda skemës *Përsëri në këmbë* (1970). Në pamundësi për t’u zhvilluar në atë hapësirë të ngushtë te *Vdekja e Zotit Kaloti* (1981) e ndonjë vepër tjetër, është zgjeruar shtrati i saj realist, i qarkuar nga disa “kulla” mbrojtëse të realizmit socialist. Pavarësisht luhatjeve të mëdha, edhe ajo, ka luajtur rol në forcimin e realizmit, në ato rrethana, të “realizmit të penguar”. Romanet e tij dallohen për shkakësimin psiko-shpirtëror të bëmave të personazheve, analizën psikologjike të hollësishme, thjeshtësinë e strukturës, për këndvështrim dhe linjë veprimi të përqendruar në një personazh. Rrëfimi është i rrjedhshëm, për ngjarje të përditshmërisë, përshkrimi me shenjat karakteristike të domosdoshme, të kohës e të mjedisit.

Tuneli

Tuneli, me analizën psikologjike të personazheve, me emocionalizmin, dialogun dramatik të nënkuptimit, domethënien e tërësishme metaforike, është ndër romanet më të arrira të autorit, si dhe

të letërsisë shqipe në vitet 1960. Shkrimtarët e brezit të ri, mes tyre edhe Dhimitër Xhuvani, në këtë ndërkohë risish, nën shtytjet entuziaste të energjive krijuese për të pohuar vetveten, dhe të ndikuar nga klima liberalizuese e letërsisë në Bashkimin Sovjetik, prej nga sapo ishin kthyer, botuan një sërë veprash të guximshme, me frymëzim spontan dhe liri shprehjeje, pa qenë aq të vetëdijshëm për pasojat e pritshme në Shqipëri. *Tuneli*, që i referohej mjedisit dhe problematikës shoqërore të kantierit për ndërtimin e hidrocentralit në Bistricë, ka qenë, ndofta, më i kritikuari në krejt periudhën e censurës. U kritikua dhe u denigrua në gazeta dhe në revista, në mbledhje e në plenumë partie, në mbledhje punëtorësh, institucionalisht, nga lart poshtë, dhe masivisht. Një ciklon mbi një shkrimtar dhe veprën e tij. Dhimitër Xhuvani shihej si heretik, prej të cilit e keqja mund të vinte dhe nga prania e tij. Shkrimtari dhe redaktori i gazetës letrare *Drita*, në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, degdiset punëtor krahu, pikërisht, në kantierin e ndërtimit të hidrocentralit në Bistricë “*për të parë për së mbari klasën punëtore dhe heroizmin e saj*.” Punëtor, larg familjes në Tiranë, dhe pa të drejtë botimi, vazhdoi disa vjet.

Duke qenë pasqyrë e një realizmi të njëmendët, “pa cak”, *Tuneli* u godit më fort për ta shuar frymën liberalizuese, që mbartte dhe po përhapej në vendet e tjera staliniste. Me lupën e realizmit socialist kishte “nxirë realitetin, klasën punëtore, udhëheqëse e jetës shoqërore të vendit e kishte zbritur në shkallaren e masës së paorganizuar, që di vetëm të punojë, pa ideale e veprimtari tjetër”.

Sakrificat, në kushte të vështira, jetese dhe teknike, modestia punëtore, për të cilat u kritikua, nuk janë përjashtuar, përkundrazi, janë paraqitur me hollësi dhe me humanizëm. Ato nuk janë dhënë me tepri, euforike, sikurse i kërkonte propaganda. Krahas tyre dhe me përparësi paraqiten mungesat lëndore, kulturore e psiko-emocionale. Jeta është *punë, gjumë, gota konjaku dhe grindje*. Mungon kultura, familja, femra, seksi. Tuneli, ku punohet pa pushim, me ndërresa, ditë dhe natë, në pavetëdije dhe rrallë në vetëdije, projekton tunelin e seksit femëror, që mungon.

Inxhinier Gjini, shëmbëlltyra e intelektualit të shkolluar e të edukuar nga partia, megjithëse është në qendër, nuk është hero pozitiv. Në

kantierin mes maleve, ai nuk ka kënaqësi veç punës. Profesionalizmit të tij më shpesh i kundërvihen të pashkolluarit dhe partiakët. Vuan shpirtërisht, ndihet i vetmuar e i humbur. E, mbi të gjitha, është “i pamoralshëm”. Me lirinë e ndjenjave erotike rrezikoi të shkatërronte një familje. Vendosja e tij në qendër, sidomos në një mjedis punëtor, ishte çheroizim i heroit pozitiv. Shkelëse e moralit socialist, e ndershmërisë à la shqiptare, është edhe personazhi femër, infermierja, Vaide, e martuar dhe me fëmijë. Për herë të parë të *Tuneli* zbulohet në thellësi dhe me emocionalizëm, ndershmëria e shtirur, hipokrizia dhe artificializmi i familjes pa dashuri, e cila ishte thjesht një organizëm familjar, ekonomik dhe seksual. Thëniet, bëmat, ndjenjat e saj të shtypura pohojnë të kundërtën. Ndershmëria dhe e moralshmja është te dashuria, qoftë edhe kur prish familjen e sajuar.

Jeta e mbyllur në kantier, për lexuesin me kulturë, me dëshirë për lëvizje e komunikim me vende të tjera, ndërmendte Shqipërinë e shkëputur nga bota. Metafora e kantierit mes maleve, pa jetën e zakonshme, vetëm me punë dhe gjumë, merrte edhe domethënien e Shqipërisë, kantier i mbyllur në vetvete, nën letargjinë e propagandës. *Tuneli*, më qartë, se veprat e tjera, hedh dritë në zonën e fshehur të tjetërsimit të realizmit, të së drejtës dhe të misionit të shkrimtarit, ku paraqitja e gjendjeve të njëmendta, merret për nxirje të realitetit dhe ai ndëshkohet, se rrëfen e përshkruan të vërtetat.

Përsëri në këmbë

Pas “riedukimit”, duke punuar e jetuar mes punëtorëve, shkroi *Përsëri në këmbë* (1970), këtë herë për një hero punëtor. Është rasti për të parë, se si, nën trysninë e censurës zyrtare dhe të lexuesit të ideologjizuar, apo të censurës masive, shkrimtari kaloi nga të shprehurit e lirë të vetvetes në të shprehurit tërësisht nën lëkurën mbrojtëse të saj.

Në qendër dhe zotërues është hero i pozitiv, Din Hyka, mishërim i punëtorit me vetëdije, që fatkeqësinë e prerjes aksidentale të këmbëve, me vullnet të jashtëzakonshëm, e kapërceu, duke u rikthyer përsëri në punë për t’i dhënë kuptim jetës së vet dhe për të qenë i dobishëm edhe shoqërisht. Personazhet, me gjendjen shoqërore, formimin, mendësitë, bëmat dhe aspiratat shëmbëlajnë paratipa të viteve 1950. Historia e ringritjes së tij, në thelb, është historia e njëmendët e ringritjes në

këmbë e punëtorit Nuredin Hoxha, *Hero i Punës Socialiste*, të cilit i është kushtuar romani. Ai ka psikologjinë e të riut entuziast për jetën dhe shoqërinë, sepse ashtu i vegonin ato nga shndërrimet e mëdha shoqërore, ekonomike dhe kulturore, që po ndodhnin. Përprjekjet fizike stërmunduese dhe këmbimi i gjendjeve emocionale të rënda, që kalojnë nga pesimizmi dhe dëshpërimi në besim e shpresë, dhe anasjellas, nëpërshkohen nga ndjenja humanizmi. Struktura dhe ecuria e romanit në rrjedhën e përsiatjeve të vazhdueshme, në trajtën e rrëfimit të brendshëm, janë në përputhje me zbulimin e energjive mendore dhe psikologjike në vetvete për të tejkaluar të keqen. Mirëpo, liria krijuese, për pasojë, edhe origjinalizmi kanë ngecur. Për të qenë sa më i sigurt ideologjikisht duket se ka shfrytëzuar me kujdes dijet shkollore rreth realizmit socialist, që kishte marrë në Institutin e Letërsisë Botërore *Maksim Gorki*, në Moskë, njohjen e letërsisë sovjetike, gjedhjet e popullarizuara të saj. Ideja e heroit, e ngritur në ideal, për dobishmërinë e përhershme shoqërore, në çdo rrethanë e gjendje vetjake, sado e vështirë qoftë, arritja e të pamundurës për hir të saj, formulime të tij dhe të personazheve të tjera, lajtmotive dhe hollësi janë të njëllajta me të romanit *Si u kalit çeliku* të Nikollaj Ostrovskit. Sikurse për Pavël Korçaginin të *Si u kalit çeliku* zanafilla e heroizmit më të epërm është humbja e syve dhe të ecurit, pra, pamundësia për të qenë i dobishëm për shoqërinë, edhe për Din Hykën është prerja e këmbëve. Në tekst përmendet dy-tri herë romani dhe heroi i Nikollaj Ostrovskit. Ngjashëm me Pavël Korçaginin, që më të pëlqyer kishte romanin *Zekthi* të Etel Vojniçit, heroi i të cilit e frymëzonte dhe dëshironte t'i ngjante, Din Hyka ka lexuar *Si u kalit çeliku*, ua ka dhënë dhe shokëve. Vuajtja, qëllimi dhe përprjekja mbinjerëzore ishte që të mos “mbetej në bisht, jashtë kohës, jashtë jetës, duke u zvarrisur”¹. “Dua të punoj dhe unë! - thotë ai. S’dua të rri si ulok dhe të dal të shëtis, dua të bëj dhe unë diçka, s’dua të mbetem jashtë radhëve.”² “Dini ecte dhe s’i besohej se ishte bërë ushtar i kësaj ushtrie të madhe transformuese, se ia kishte arritur më në fund kësaj dite, që gjer pardje i qe dukur e paarritshme.”³

¹ Dhimitër Xhuvani, *Përsëri në këmbë*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1970, faqe 118.

² Po aty, faqe 145.

³ Po aty, faqe 187.

Lajtmotivi i jetës së Pavël Korçaginit është për të mos mbetur jashtë radhëve. “*Jam gati t’i duroj të gjitha vetëm e vetëm që të kthehem në rreshtat. Për mua s’ka gjë më të tmerrshme në jetë veç daljes nga radhët. Një gjë të tillë as nuk mund ta mendoj.*”¹; “*A bëre gjithçka që të thyesh rrethin e hekurt dhe të kthehesh rishtas në rreshtat e luftëtarëve, që ta bësh jetën tënde të dobishme?... Zemra i rrahu shpejt e më shpejt. Ja, u përmbush ëndrra e kaq e kaq viteve! U thye rrethi i hekurt. Me një armë të re në dorë, Korçagini kishte zënë vend përsëri në radhët e luftëtarëve dhe në jetë.*”² Pavlit, pa sy dhe ulok në shtrat, shokët i sjellin një radio për të qenë i lidhur me botën dhe jetën nga e cila është shkëputur fizikisht. “*Në mëngjez, disa njerëz hipën në çati për të ngritur një antenë, ndërsa brenda në shtëpi Levi punoi për të vendosur një radio... Në të ngrysur, në dhomë u ndezën tri llamba ‘mikro’. Levi i zgjati tërë gaz Pavlit kuffet e radios. Në eter mbretëronte një kaos tingujsh... Në mes të kësaj rrëmuje zhurmash dhe tingujsh, bobina e variometrit kapi atë që kërkonte dhe solli një zë të qetë që lajmëroi: - Dëgjoni, dëgjoni! Ju flet Moska! Aparati i vogël kapte me antenën e tij gjashtëdhjetë stacione të të gjithë botës. Jeta, nga e cila Pavli ishte shkëputur, vërshonte tani në dhomë nëpërmjet të një cipe çeliku, dhe ai ndjeu frymëmarrjen e saj të fuqishme.*”³

*Edhe Dinit shokët i sjellin një radio për të ndjekur jetën dhe punën tej mureve të shtëpisë dhe shtratit ku dergjet. “Dini e preku pakon me të dyja duart dhe u trondit, si të kishte prekur me duart që i dridheshin botën, që e shqetësonte dhe e brengoste, atë botë të madhe, që e ndillte dhe ku ai s’kish kurajo e guxim të hynte. - Është radio... E mori radion (Titi), e vuri mbi komodinën pranë shtratit dhe ia shkeli syrin ‘Elektro-autitit’. ... Të gjithë qeshën, veç Dinit, i cili e kishte mendjen gjithë te ajo botë e madhe, që i hyri aq papritur e aq gëzueshëm në shtëpi e në shpirt... Më në fund, pasi gjeti stacionin e Tiranës, hapi zërin në maksimum. Në dhomën përdhese buçiti kënga.”*⁴ Është e njëjta situatë,

¹ Nikollaj Ostrovski, *Si i kalit çeliku*, përktheu Dhimitër Pasko, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë 1973, faqe 449.

² Po aty, faqe 493.

³ Po aty, faqe, 484-485.

⁴ Dhimitër Xhuvani, *Përsëri në këmbë*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1970, faqe 74-75.

gjendje shpirtërore e dëshpëruar e heronjve, e njëjta ide e solidaritetit kolektivist, i njëjti mjet, radioja për të arritur qëllimin, ngritjen moralo-emocionale të tyre.

*Përsëri në këmbë vlerësohej ndër veprat më të arrira të realizmit socialist, me gjithë ngjashmëritë e dukshme me romanin *Si u kalit çeliku*, të cilat kritikët dhe studiuesit më të njohur i dinin fare mirë, sepse kishin dalë nga shkolla sovjetike. Edhe më tepër e çmonin lexuesit e ideologjizuar. Në një kopje të Bibliotekës Kombëtare, S 93/29 G, si rrallë në kopje të tjera, janë këto shënime lexuesish: “E lexova më datë 14 shkurt të 1973. I bukur shumë. Firma”;*

“Një libër ky, që më la mbresa të thella. Dini do të mbetet një shëmbull heroizmi, guximi dhe trimërie. Dini që me këmbënguljen e tij, me ndërgjegjen e pastër të tij arriti të ngrihej përsëri në këmbë dhe të bëhej një punëtor i dalluar, një komunist, një agjikator i flaktë i partisë, se të tillë e edukoi partia me vullnet të çeliktë. Romani Përsëri në këmbë do të mbetet një shëmbull frymëzimi në mendjet dhe zemrat e rinisë sonë. Nëndor. 1977.”;

“Jam nxënëse e shkollës Andon Zako Çajupi, viti i parë gjimnaz. Ky libër më la mbresa të thella. Përpyekjet e Dinit për të ecur e bëjnë sa më tërheqës këtë libër. Për mua ky është një libër nga më të bukurit dhe tërheqës që kam lexuar gjatë gjithë këtij viti. Atë që bëri Dini mund ta bëjë çdo i ri në vendin tonë dhe më shumë. Këtë libër e lexova më datë 26-X-1987. Firma”;

“Është libër me kuptim të madh”;

“Jam nxënëse i shkollës së mesme Andon Zako Çajupi, viti i parë gjimnaz. Ky libër është një nga librat që më ka lënë mbresa më shumë pothuajse nga çdo libër që kam lexuar. Është libër shumë tërheqës. Të tërheq jashtë mase lufta shpirtërore midis Dinit e fatkeqësisë që i ndodhi. Ka kuptim të gjerë figurativ. Ajo që bëri Dini të bëhet shëmbull për rininë tonë. Firma. 11-X-1989.”;

“Të gjitha përshtypjet këtu (është fjala për shënimet e lartëshkruara të lexuesve të tjerë) janë dhënë në ato vite kur unë nuk kisha lindur akoma. Unë këtë libër e lexova me shumë dëshirë dhe nuk kam gjetur as nuk kam për të gjetur fjalë për të thënë mbresat e mia. Një rini si kjo (Dini) i duhet vendit tonë, e guximshme, këmbëngulëse dhe me ideale të

larta. 24-03-05. Firma. Nga një nxënëse në Fakultetin e Infermierisë, Tiranë, 2005.”

Kahu, apo drejtimi i disidencës

Kahu, apo drejtimi i disidencës¹ përbëhet nga krijimtaria disidente, kundërtotalitare. Ajo ishte heterogjene, e hapur, përfshinte brendi e poetika të ndryshme, realiste, moderne, moderniste. Në literaturë dhe histori të letërsive europiane është quajtur edhe krijimtaria e “sirtarëve”, sepse mbeti në dorëshkrim, e fshehur nëpër sirtarë. U shkrua në vitet 1945-1990, krahas asaj të realizmit socialist. Duke qenë kundër realizmit socialist botimi i saj ishte i ndaluar rreptësisht. Autorët përndiqeshin një lloj, me burgim dhe internim, si ata që e paraqisnin për botim, edhe ata që merrej vesh se kishin shkruar të atij lloji. Nuk munguan as rastet e dënimit kapital. Poetët e rinj Trifon Xhagjika (1963), Vilson Blloshmi dhe Genc Leka (1977) përfunduan tragjikisht, edhe pse poezitë nuk i kishin paraqitur për botim, por thjesht i mbanin në fletoret e tyre.

¹ I. **Disidencë**, fjalë e prejardhur prej latinishtes, e shfaqur në shekullin XV në disa gjuhë neolatine dhe e përdorur rrallë deri nga fundi i shekullit XVIII. **1.** Veprim ose gjendje e atyre që ndahen prej një bashkësie fetare, politike, shoqërore, prej një shkolle filozofike; **ndarje, rebelim, revoltë, përçarje, shkëputje**. Thuhet: jam, hyj në disidencë. Bëj disidencë. Disidencë me pushtetin. Grup disidentësh. Bashkoj disidencën.

2. Në letërsi: ndryshim mendimi; **mosmarrëveshje, grindje, konflikt; mospajtim, kundërshtim mendimesh, shijesh; divergjencë, largim, shpërndarje.**

Disident,-e, ai që është në disidencë, që bën pjesë në një disidencë. **Heretik, jokonformist, i përkundërt, rebel, i revoltuar, përçarës, ndarës/separatist.** Parti disidente, disidentë të burgosur. *Le Petit Robert 1*, 2003, faqe 767-768.

Këto janë kuptimet e përgjithshme. Fjala *disidencë* dhe *disident,-e*, te *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, nuk ishte përfshirë. **II. Disidencë dhe disidentët** janë dukuri të përgjithshme, universale në jetën shoqërore e politike, në fe, në letërsi, në mendimin shkencor, ndërsa, në shekullin XX, sidomos në gjysmën e dytë të tij, morën një kuptim politik dhe letrar më të ngushtë, më të kufizuar. Fjala *disidencë*, në letërsi, shprehte mospranimin, procesin e ndarjes, të shkëputjes dhe të kundërshtimit të hapur, publik ndaj metodës dhe letërsisë së realizmit socialist. Në kuptimin shoqëror e politik shprehte mospranimin, procesin e shkëputjes dhe të kundërshtimit të hapur, publik

Krijimet kanë dy datëlindje, të shkrimit dhe të botimit. Në Shqipëri dolën në dritë me rënien e censurës, pas 1990-s. Në diasporë kishin dalë me kohë, por nuk kishin qarkulluar në atdhe. Shkaku i lindjes ka qenë mungesa e lirisë së mendimit, përpjekjet për të ruajtur natyrshmërinë e vetëshprehjes dhe të letërsisë. Është shfaqur në forma të hapëta dhe të tërthorta, simboliko-alegorike, paradoksale që me vendosjen e censurës, pranimin e metodës së realizmit socialist si të vetmen metodë krijuese. Me rënien e tyre, me lejimin e mendimit të lirë mbaron periudha e të shkruarit të saj, e humbet këtë kuptim dhe funksion.

Lëvrimi i saj ka qenë tepër i vështirë, sepse censura ishte e pakapërcyeshme. Duke mos mundur të sendërtonte funksionin e qeniesisë së vet, mbërritjen te lexuesi, i mbetej fishkja e zhbërja, ose zhvillimi i mbyllur në vetvete, nëpërmjet sakrificave sublimuese të

ndaj socializmit totalitarist. Këtë përmbajtje mori fillimisht në Rusinë Sovjetike me fitoren e Revolucionit leninist të Tetorit (1917), më pas, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Lindjes me sistemin politik stalinist, ku u vendos censura, që nuk lejonte mendimet e lira politike dhe letrare. Mungesa e lirisë krijoi vetvetiu mospranimin e asaj që ishte e detyrueshme, kundërshtimin, shkëputjen, disidencën dhe disidentët. Romani i Boris Pasternakut *Doktor Zhivago* (1957, Itali), i nderuar me Çmimin Nobel (1958); *Arqipelagu Gulag* (1973, jashtë Bashkimit Sovjetik) i Aleksandër Sollxhenicinit, dëbuar prej Bashkimit Sovjetik, nderuar, me Çmimin Nobel (1970), janë të njohur në mbarë botën, si dhe emrat dhe vepra e disidentëve të tjerë ruso-sovjetikë: Ana Ahmatova, Vasili Bikov, Fedor Abramov, Anatoli Gladilin, Ilia Erenburg, etj. Me emër janë edhe disidentët çekoslovakë: Jaroslav Seifer, dhënë Çmimi Nobel (1984), Edvard Valenta, Vaclav Havel, Milan Kundera; rumunë: Jon Karejon, Nikita Stanesku, Marin Soresku, Ana Blandiana; hungarezë: Béla Hamvas; të tjerë, bullgarë, gjermano-lindorë, kinezë, koreano-veriorë.

Meqenëse në atdhe nuk u botoheshin veprat dhe dënoheshin, kur kishin mundësi largoheshin dhe shkonin në vendet e Perëndimit. Në disa raste edhe vetë shtetet kanë lejuar shkrimtarë që të largohen, me përjashtim të Shqipërisë. Në Europën Perëndimore dhe në SHBA formuan qendra të organizimit dhe të botimit. Në mërgim, më të njohurit kanë qenë: shkrimtarët rusë: Jozef Brodskij, Çmimi Nobel (1987), Vladimir Maksimov; polakë: Çeslav Milosh, Çmimi Nobel (1980), Vitold Gombroviç; hungarezët Lajos Zilahy, Sándor Márai. Kjo lloj disidencë dhe këta lloj disidentësh kanë qenë dukuri e socializmit totalitarist.

shkrimtarëve, pa motiv e kënaqësi leximi prej të tjerëve. Në Shqipëri nuk u botua asnjë vepër disidente e mirëfilltë. E veçanta e saj ishte se shkruhej dhe nuk botohej. Në vende të tjera arritën të botoheshin disa, madje nga autorët më të rëndësishëm. Për këtë më shpesh është keqinterpretuar. Disidencën është kur mospranimi dhe kundërshtimi shprehen me vetëdije, hapur dhe publikisht. E, meqenëse, në Shqipëri, nuk ndodhi kështu, me përjashtim të disa rasteve në trajta letrare simbolike e analogjike, ka qenë më e lehtë të besohej mendimi, se nuk ka pasur disidencë. Mirëpo, krijimtari të tillë ka pasur dhe nuk mund të mohohet. Qeniesia e saj në dorëshkrim do të pranohet në gjendjen që është, me mungesë treguesish, pasojë e rrethanave në të cilat mbijetoi. Nën mbikëqyrje, në internim dhe burgje, pa pasur as kushtet më të thjeshta praktike, me përparësi është lëvruar poezia, që ngjizej përmendësh, e hidhej në copa të vogla letrash për t'u fshehur lehtësisht. Janë shkruar edhe proza të shkurtra, romane e drama.

Shkrimtarët me stile të formësuara në vitet 1920-1930, në masën më të madhe, nuk e pranuan realizmin socialist, disa e shprehën haptas dhe disa me heshtje. Sidoqoftë, edhe në rrethanat plot trysni, vazhduan me stilet e tyre, prandaj, veprat nuk u botuan. Konflikti i heshtur u kthye në konflikt zyrtar. Ata u mënjanuan nga jeta shoqërore, u internuan dhe u burgosën për biografi, qëndrime politike e bindje letrare, ndër ta, Ethem Haxhiademi, Mitrush Kuteli, Mustafa Greblleshi, Musine Kokalari, Arshi Pipa, etj. Disidentët e parë, në kuptimin e mirëfilltë, kanë qenë Sefulla Malëshova e Ymer Dishnica, që dolën nga ideologjia komuniste.